



Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE
Të caktuara për 5 qershor 2016

**Raporti përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin
e zgjedhjeve**



Varshavë
8 korrik 2016

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	1
II.	HYRJE DHE FALËNDERIME	3
III.	KONTEKSTI POLITIK	4
IV.	KORNIZA LIGJORE	7
V.	SISTEMI ZGJEDHOR	8
VI.	ADMINISTRATIMI I ZGJEDHJEVE	9
VII.	REGJISTRIMI I VOTUESVE	11
	A. AZHURNIMI I REGJISTRIT TË VOTUESVE	11
	B. SHIKIMI PUBLIK I LISTAVE ZGJEDHORE	13
VIII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE	14
IX.	FINANCIMI I FUSHATËS	15
X.	MEDIAT	16
	A. MJEDISI MEDIATIK	16
	B. KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT	17
	C. KONSTATIMET NGA MONITORIMI I MEDIAVE	19
XI.	VËZHGESIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË	20
XII.	KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT	20
XIII.	PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE	22
XIV.	REKOMANDIMET	23
	A. REKOMANDIMET PRIORITARE	23
	B. REKOMANDIMET E TJERA.....	24
ANEKSI II:	LISTA E VËZHGESVE NË MISIONIN PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE	26
	PËR OSBE/ODIHR-IN	26

**ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË
ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE
TË CAKTUARA PËR 5 QERSHOR 2016**

Raporti përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve¹

I. PËRMBLEDHJE

Në përgjigje të ftesës zyrtare, Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) më 31 mars e krijoi Misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) për t'i vëzhguar zgjedhjet e parakohshme parlamentare të caktuara për datën 5 qershor. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i ndërpreu aktivitetet e saj vëzhguese më 1 qershor, pas anulimit të zgjedhjeve. Misioni vlerësoi se a u zhvilluan proceset dhe aktivitetet zgjedhore deri në atë datë në përputhje me angazhimet e OSBE-së, obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe legjislacionin e vendit.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare u caktuan si pjesë e marrëveshjes shumëpartiake të Përzhinës që kishte për qëllim t'u japë fund tensioneve politike që buronin nga bojkotimi i parlamentit nga ana e opozitës dhe publikimi i inçizimeve të komunikimeve përgjuara për shpërdorimin e pretenduar të fuqisë nga ana e zyrtarëve të lartë qeveritarë dhe publikë. Kriza politike u thellua pasi opozita njoftoi se ka ndërmend t'i bojkotojë zgjedhjet për shkak se nuk janë plotësuar kushtet kryesore të marrëveshjes. Pas negociatave, parlamenti i shtyri zgjedhjet e parakohshme për 5 qershor, të cilat fillimisht ishin caktuar për 24 prill. U organizuan demonstrata të vazhdueshme për t'i anuluar zgjedhjet si dhe kundër-demonstrata në mbështetje të mbajtjes së zgjedhjeve.

Klima politike poashtu u ndikua edhe nga vendimi i kryetarit të shtetit, Gjorge Ivanov, për t'u dhënë amnisti të përgjithshme të gjithë personave që ishin të paditur, nën hetime ose të dyshuar për përfshirje në skandalin e përgjimeve.

Nga katër palët nënshkruese të Marrëveshjes së Përzhinës, vetëm partia në pushtet dorëzoi lista të kandidatëve deri në afatin e fundit më 11 maj. Dy parti joparlamentare, të cilat dorëzuan lista të kandidatëve, u refuzuan për arsye teknike. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it theksuan se mbajtja e zgjedhjeve me vetëm një garues, e vë në pikëpyetje pluralizmin politik. Disa përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare theksuan se çdo qeveri që do të rezultonte nga zgjedhjet në të cilat nuk do të merrnin pjesë tre partitë më të mëdha, nuk do të ishte partner i besueshëm.

Më 18 maj Gjykata Kushtetuese lëshoi ndalesë të përkohshme kundër vendimeve të parlamentit që ishin rezultat i shpërbërjes së tij, edhe pse më parë parlamenti kishte vendosur se nuk ka kompetencë që t'i shqyrtojë këto dy raste. Më 25 maj, Gjykata e shpalli shpërbërjen e parlamentit si jokushtetuese. Para se të merrej vendimi përfundimtar i gjykatës, parlamenti u rimblodh dhe votoi që t'i anulojë zgjedhjet e 5 qershorit. Qeveria u rikthye në përbërjen që e kishte para Marrëveshjes së Përzhinës.

Edhe pse autoritetet ndërmorrën disa masa për ta parandaluar frikësimin dhe presionin ndaj qytetarëve, shpeshherë shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it pretendonin se ka një mjedis të frikësimit. Disa prej tyre, këtë ia përshkruan frikës nga hakmarrja që ekziston në ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka pranuar pretendime të

¹ Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar. Janë siguruar përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

besueshme të presionit mbi të punësuarit në sektorin publik për të marrë pjesë në kundërdemonstrata, duke përfshirë edhe kërcënime për largim nga puna. Kjo e ka vënë në pyetje të drejtën e votuesve për të votuar pa u frikësuar nga hakmarrja, siç është paraparë në paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

Në pjesën më të madhe, zgjedhjet janë të rregulluara me Kushtetutë dhe me Kodin zgjedhor. Në nëntor të vitit 2015 parlamenti miratoi një numër të konsiderueshëm të ndryshimeve në Kodin zgjedhor. Me këto ndryshime u bë përpjekje për ta trajtuar shumicën e rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it. Megjithatë, një numër i bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it theksuan se po aq i rëndësishëm është edhe implementimi i plotë i Kodit zgjedhor. Ndryshimet e vonshme ndikuan negativisht në aspekt të kuptimit të dispozitave të reja nga ana e palëve të përfshira në procesin zgjedhor, si dhe në aftësinë e tyre për t'i kryer funksionet e tyre. Edhe pse këto ndryshime paraqesin përpjekje për ta përmirësuar Kodin zgjedhor, bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it kishin mendim të ngjashëm se Kodi zgjedhor ka nevojë për rishikim të plotë për shkak të mospërputhjeve të brendshme dhe mungesës së koherencës.

Ndërmjet 120 dhe 123 deputetë janë zgjedhur sipas sistemit proporcional të përfaqësimit nga listat e mbyllura. Prej tyre, 20 deputetë janë zgjedhur në secilën nga 6 njësitë zgjedhore të vendit. Si rezultat i ndryshimeve të vitit 2015 në Kodin zgjedhor, deri në tre deputetë mund të zgjidhen nga njësia e vetme zgjedhore jashtë vendit. Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të votuesve të regjistruar jashtë vendit, votimi jashtë vendit u anulua, me çka në mënyrë efektive iu mor e drejta e votimit një numri të votuesve.

Zgjedhjet menaxhohen nga administrata zgjedhore në tre nivele, e udhëhequr nga Komisioni shtetëror zgjedhor (KSHZ). Me ndryshimet e vitit 2015 u ndryshua përbërja e KSHZ-së dhe u rritën kompetencat e saj për ta përfshirë edhe mirëmbajtjen e regjistrit të votuesve.

KSHZ-ja punoi në një ambient të tensionuar politik dhe u kritikua nga opozita dhe disa organizata të shoqërisë civile, të cilat ishin kundër mbajtjes së zgjedhjeve më 5 qershor. Ajo i respektoi afatet administrative dhe mbajti mbledhje të rregullta. Përkundër obligimit ligjor për të mbajtur mbledhje publike, KSHZ-ja mbajti dy sesione të mbyllura zyrtare, e poashtu rregullisht mbajti “sesione pune” që ishin të mbyllura për publikun. Vendimet e saj nuk u publikuan në mënyrë sistematike në ueb-faqen e saj, gjë që e dobësoi transparencën e punës së saj. Poashtu, mbledhjet e KSHZ-së u bojkotuan nga dy anëtarë të KSHZ-së.

Përderisa zyrat rajonale të KSHZ-së rezultuan të ishin të ekuipuar me punëtorë me përvojë, zyrtarët lokalë të zgjedhjeve dukej se nuk kishin asnjë fuqi vendimmarrëse. Shumë prej tyre u ankuar për mungesën e resurseve të nevojshme, si dhe mbështetjen dhe udhëzimet e pamjaftueshme nga ana e zyrës qendrore. Madje, riemërimi i anëtarëve të Komisioneve komunale zgjedhore u bë gjatë procesit zgjedhor, që ndikoi në punën e tyre, duke e përfshirë edhe formimin e Këshillave zgjedhorë.

Sistemi aktual i regjistrimit të votuesve që bazohet në numrin e vetëm amë mund të sigurojë saktësi të listave zgjedhore dhe të ofrojë masa të mjaftueshme mbrojtëse kundër regjistrimit të rrejshëm dhe atij të dyfishtë nëse zbatohet në mënyrë konsekuente dhe të drejtë. Edhe pse KSHZ-ja bëri përpjekje të konsiderueshme për ta realizuar në kohë azhurnimin e regjistrit të votuesve duke bërë kontrollim të kryqëzuar të bazave të të dhënave dhe kontrole në terren, ky proces u tregua si i ndërlikuar, sfidues në aspekt metodologjik, e poashtu kërkonte edhe resurse të mëdha. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it e kritikuan procesin se është kaotik, i pasigurt në aspekt metodologjik dhe se në disa raste i ka trajtuar në mënyrë joadekuate pretendimet e mëparshme për mashtrim.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua për një numër rastesh të ekzistimit të pretenduar të votuesve fiktivë dhe për parregullsi të tjera. Megjithëse shumë pretendime u dëshmuar si të pavërteta, ose kishin të bëjnë me gabime gjatë regjistrimit, të cilat tashmë ishin korrigjuar, u vërejtën raste të votuesve që ishin të regjistruar në adresa që nuk ekzistonin, që mund të jetë ose regjistrim i rrejshëm ose gabim administrativ. Duke i trajtuar këto pretendime, MPB-ja njoftoi se deri më 31 mars 2016 në regjistrin e shtetasve kishte 2,464,925 qytetarë, duke i përfshirë edhe 1,956,518 qytetarë të moshës madhore – që mund të votojnë. Raporti për përparimin në azhurnimin e listave zgjedhore që u publikua nga KSHZ-ja më 26 prill nuk zbuloi dëshmi për regjistrim të rrejshëm të votuesve.

Mjedisi mediatik është i ndarë në baza etnike dhe karakterizohet me një numër të madh të shtëpive mediatike që veprojnë në treg të kufizuar të reklamave. Një numër i bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën brengosje për përkeqësimin e lirisë së mediave për shkak të presionit politik dhe ndërhyrjes së pronarëve në punën e gazetarëve. Disa theksuan se përzgjedhja e transmetuesve për reklamim nga ana e qeverisë është shpërblim për mbulimin e favorshëm dhe politikën redaktuese.

Korniza ligjore për mbulimin e zgjedhjeve u ndryshua në masë të konsiderueshme; megjithatë, shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it e potencuan nevojën për reforma më thelbësore. Si pjesë e Marrëveshjes së Përzihës u mbajtën konsultime ndërmjet katër partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile për ta reformuar edhe më tutje hapësirën mediatike, mirëpo ndryshimet e propozuara u hodhën poshtë nga parlamenti në prill.

Monitorimi i mediave nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it tregon se edicionet informative të RTM-1 ofruan informata të kufizuara për ngjarjet politike dhe iu shmangën raportimit gjithëpërfshirës gjatë mbulimit të tyre ditor të lajmeve. Në disa raste, gazetarët e RTM-1 i përzier faktet me mendimet e tyre politike gjatë mbulimit të lajmeve. Stacionet më të popullarizuara private televizive, *Sitel* dhe *Kanal 5*, së bashku me televizionin *Alfa*, treguan qasje të njësuara në mbulimin e lajmeve, edhe atë ekskluzivisht pozitive dhe neutrale ndaj partisë në pushtet dhe negative ndaj partisë kryesore opozitare. *Telma* dhe televizioni që emetohet vetëm në kabëll *Vesti 24* ofruan mbulim më të balancuar dhe më të detajuar të lajmeve.

Me ndryshimet e vitit 2015 të Kodit zgjedhor u përshtatën afatet për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për kundërshtimet zgjedhore dhe u parapa që të gjitha seancat për shqyrtim të organeve administrative të jenë të hapura për publikun. Përkundër dispozitës kushtetuese për të mbajtur sesione gjyqësore publike, Gjykata Administrative veprroi në mënyrë jotransparente, dhe i shqyrtoi dy raste që kishin të bëjnë me zgjedhjet pa mbajtur seancë publike. Poashtu, mungesa e udhëzimeve të përhershme për procesin e kundërshtimeve e dëmton efektivitetin e mjeteve ligjore të ndreqjes, që është paraparë me paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

II. HYRJE DHE FALËNDERIME

Në përgjigje të ftesës zyrtare, dhe në bazë të rekomandimit nga Misionit për vlerësimin e nevojave të realizuar prej 2 deri më 5 nëntor 2015, Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut e OSBE-së (OSBE/ODIHR) më 31 mars e krijoi Misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) për t'i vëzhguar zgjedhjet e parakohshme parlamentare të caktuara për 5 qershor 2016. MVZ-ja, e udhëhequr nga ambasadori Jan Petersen, përbëhej nga ekipi bazë prej 12 anëtarëve, të vendosur në

Shkup dhe 24 vëzhguesve afatgjatë (VA) të vendosur në gjithë vendin që nga 13 prilli. Anëtarët e misionit u siguruan nga 21 Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së.²

Me anulimin e zgjedhjeve më 18 maj, më 1 qershor MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i përfundoi aktivitetet e saj vëzhguese. Megjithatë, misioni e vlerësoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor dhe aktivitetet e zhvilluara deri në atë datë, me angazhimet e OSBE-së, me detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas. Ky raport përfundimtar pason pas dy Raporteve të përkohshme.³

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it dëshiron t'i falënderojë autoritetet për ftesën për t'i vëzhguar zgjedhjet, si dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), Ministrinë për Punë të Jashtme dhe autoritetet e tjera shtetërore dhe lokale për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre gjatë veprimit të MVZ-së. Misioni, poashtu i shpreh falënderim edhe Misionit të OSBE-së në Shkup,⁴ organizatave të tjera ndërkombëtare dhe ambasadave të akredituara në Shkup, si dhe partive politike, organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të mediave për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre.

III. KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare u caktuan si pjesë e Marrëveshjes së Përzhinës, të nënshkruar më 2 qershor 2015 dhe Protokollit të saj të datës 15 korrik, të cilat u përgatitën për t'iu dhënë fund tensioneve politike që buronin nga bojkotimi i parlamentit nga ana e opozitës dhe publikimi i inçizimeve të komunikimeve përgjuara për shpërdorimin e pretenduar të fuqisë nga ana e zyrtarëve të lartë qeveritarë dhe publikë.⁵

Kjo marrëveshje, që u arrit ndërmjet katër partive kryesore - Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partisë Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), Lidhjes Socialdemokratike të Maqedonisë (LSDM), Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI), dhe Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), u ndihmua nga Komisioni Evropian (KE).⁶ Zgjedhjet e parakohshme fillimisht u caktuan për 24 prill 2016.

Në janar të vitit 2016, LSDM-ja njoftoi se nuk do të marrë pjesë në zgjedhje, duke theksuar se nuk janë plotësuar kushtet kryesore të Marrëveshjes së Përzhinës, edhe atë pastrimi i listës së votuesve,

² Nga Shtetet pjesëmarrëse u kërkua të ofrojnë 300 vëzhgues afatshkurtër për t'i vëzhguar procedurat në ditën e zgjedhjeve.

³ Shihni [Raportet e përkohshme të MVZ-së](#), si dhe [raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it](#) për ish-Republikën jugosllave të Maqedonisë.

⁴ [MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it](#) dhe [Misioni i OSBE-së në Shkup](#) funksionojnë ndaras, në bazë të mandateve të veçanta.

⁵ Zgjedhjet e fundit (të parakohshme) parlamentare janë mbajtur më 27 prill 2014 dhe rezultuan me qeverinë e formuar nga koalicioni i VMRO-DPMNE-së me 61 deputetë dhe BDI-ja me 19 deputetë. Opozita e përfshinte LSDM-në me 34 deputetë dhe PDSH-në me 7 deputetë. Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK) dhe Opcioni qytetar për Maqedoninë (GROM) kishin nga një deputet.

⁶ Shih [Marrëveshjen e Përzhinës](#) dhe [Protokollin](#), me të cilat parashihej implementimi i një sërë masash gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e krizës politike, duke i përfshirë edhe reformat zgjedhore dhe ato mediatike. Afatet kohore për të cilat u arrit marrëveshje ishin 31 korriku i vitit 2015 për emërimin e Komisionit të ristrukturuar Shtetëror të Zgjedhjeve (u emërua më 15 dhjetor), 1 shtatori për kthimin e LSDM-së në parlament, 15 shtatori për emërimin e Prokurorit special për t'i shqyrtuar inçizimet e komunikimeve të përgjuara, 20 tetori për emërimin e ministrave dhe zëvendës-ministrave të LSDM-së (u emëruan më 11 nëntor), dhe 15 janari i vitit 2016 (100 ditë para zgjedhjeve) për tërheqjen e kryeministrit nga funksioni.

reformat e mediave, dhe ndarja e shtetit nga aktivitetet partiake.⁷ Më 23 shkurt, parlamenti e miratoi propozimin e BDI-së për ta shtyrë shpërbërjen e parlamentit dhe më 15 prill kryetari i parlamentit i rikaktoi zgjedhjet për 5 qershor.

Klima politike u përkeqësua pas 12 prillit, kur kryetari i shtetit, Gjorge Ivanov solli vendim për amnisti të përgjithshme për të gjithë ata që ishin të paditur, nën hetime ose të dyshuar për përfshirje në skandalin e përgjimeve.⁸ Të gjitha partitë kryesore politike e dënuan amnistinë dhe i bënë thirrje kryetarit të shtetit që ta tërheqë vendimin e tij. Amnistia shkaktoi protesta dhe kundër-protesta.⁹ Të bashkuar nën ombrellën e lëvizjes *Protestoj*, demonstruesit kërkuan dorëheqjen e kryetarit të shtetit dhe anulimin e zgjedhjeve. Edhe pse përfaqësuesit e lëvizjes *Protestoj* deklaruan se janë të pavarur politikisht, VMRO-DPMNE-ja thoshte se protestat janë të orkestruara nga LSDM-ja. Kundër-protestat e organizuara nga Lëvizja qytetare për mbrojtjen e Maqedonisë (GDOM) e mbështesnin qëndrimin e qeverisë duke pohuar se zgjedhjet duhet të mbahen më 5 qershor.

Edhe pse autoritetet ndërmorrën disa masa për ta parandaluar presionin mbi qytetarët, si për shembull deklaratat politike dhe vendosja e lidhjeve të drejtpërdrejta telefonike (hot-line), shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shpeshherë pretendonin se ka klimë të frikësimit, dhe disa prej tyre këtë ia përshkuanin frikës nga hakmarrja që ekziston në institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore. Edhe pse nuk është parashtruar asnjë ankesë zyrtare, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka pranuar pretendime të besueshme për presion ndaj të punësuarve në sektorin publik për të marrë pjesë në kundër-protesta, duke i përfshirë edhe kërcënimet për largim nga puna.¹⁰ Kjo e vë në pikëpyetje të drejtën e votuesve për të votuar pa u frikësuar nga hakmarrja, siç është paraparë me Dokumentin e Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.¹¹

Qytetarët, duke i përfshirë edhe të punësuarit në institucionet publike ose shtetërore, nuk duhet t'i nënshtrohen presionit ose frikësimit. Autoritetet duhet t'i inkurajojnë qytetarët në mënyrë aktive që

⁷ Më 21 shkurt, ambasadorët e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e publikuan [letrën e përbashkët](#), duke thënë se “momentalisht nuk ekzistojnë kushtet e nevojshme për organizimin e zgjedhjeve të besueshme më 24 prill”.

⁸ U amnistuan gjithsej 56 persona, duke i përfshirë edhe kryetarët e VMRO-DPMNE-së dhe të LSDM-së, ish-zyrtarë të qeverisë, politikanë, të punësuar në Prokurorinë speciale publike, një anëtar i KSHZ-së, një ish-anëtar i Komisionit komunal zgjedhor dhe disa afaristë.

⁹ Gjatë demonstratave të 13-14 prillit, u lënduan gjashtë persona dhe u dëmtuan disa ndërtesa, duke e përfshirë Zyrën Popullore të kryetarit të shtetit. Në demonstratat që pasuan, u spërkatën me ngjyrë ndërtesat shtetërore dhe përmendoret. U arrestuan gjithsej 13 njerëz dhe u dënuan me vlerë të përgjithshme prej 15.000 eurosh për “pjesëmarrje në turmë me qëllim të dëmtimit të pronës”, ndërsa 3 veta u dënuan me kusht, me dënim me burg deri në një vjet. Për dy anëtarë të partisë *Levica* fillimisht u caktua arrest shtëpiak për 8 ditë, i cili u zgjat dy herë nga 30 ditë. Poashtu, tre përfaqësues të Komitetit të Helsinkit u dënuan me nga 50 euro për dëmtimin e përmendoreve të trashëgimisë kulturore.

¹⁰ Në katër raste të vërtetuara, të punësuarit publikë ose arsimtarët janë urdhëruar me anë të porosive tekstuale që të marrin pjesë në kundër-protesta në Shkup. Dy të punësuar në sektorin publik në Strugë e informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se u është thënë nga një përfaqësues i VMRO-DPMNE-së që të shkojnë në kundër-protesta në Shkup më 13 prill. Zëvendës-avokati i popullit në Manastir i tha MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se 20 njerëz kanë ardhur në zyrë për të pyetur se si të reagojnë ndaj kërcënimeve për transferim, degradim të pozitës së punës dhe largim nga puna, që i kanë marrë nga udhëheqësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve shtetërore, në qoftë se nuk e mbështesin VMRO-DPMNE-në.

¹¹ Paragrafi 7.7 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 i obligon Shtetet pjesëmarrëse “që ta sigurojnë funksionimin e ligjit dhe politikës publike, në mënyrë që e lejon realizimin e fushatës politike në atmosferë të drejtë dhe të lirë, ku as veprimi administrativ, as dhuna e as frikësimi nuk do t'i pengojë partitë dhe kandidatët që t'i shprehin pikëpamjet dhe aftësitë e tyre, ose që i parandalon votuesit nga mësimi ose diskutimi mbi çështjet e cekura ose nga hedhja e votës së tyre – pa frikë nga hakmarrja”. Shih poashtu [Udhëzimet e përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit për demokraci nëpërmjet ligjit \(Komisioni i Venedikut\) të Këshillit të Evropës \(KE\) për parandalimin dhe përgjigjen ndaj keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë proceseve zgjedhore](#).

t'i denoncojnë të gjitha rastet e presioneve, duke i mbështetur ato me dëshmi të verifikueshme. Të gjitha rastet dhe pretendimet për presion dhe frikësim duhet të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe të ndiqen penalisht nga autoritetet.

Periudha para fushatës u karakterizua me këmbim të retorikës së ashpër ndërmjet partive kryesore politike, veçanërisht ndërmjet VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së. VMRO-DPMNE-ja theksonte se mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme është mënyra e vetme për dalje nga kriza, ndërsa për LSDM-në prioritet ishte implementimi i Marrëveshjes së Përzhinës para se të mbahen zgjedhjet. Më 9 prill, LSDM-ja dhe 17 parti më të vogla e nënshkruan Platformën për Maqedoni demokratike, ku kërkonin implementimin e Marrëveshjes së Përzhinës dhe njoftuan se do t'i bojkotojnë zgjedhjet. Në fund, BDI-ja dhe PDSH-ja thanë se ata janë për zgjedhje inkluzive, ku do të marrin pjesë të gjitha partitë.

Shumica e partive ishin në pritje të përfshirjes më të madhe të bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës. Pas negociatave, nuk u arrit ndonjë marrëveshje politike, dhe nga katër partitë nënshkruese të Marrëveshjes së Përzhinës, vetëm VMRO-DPMNE-ja dorëzoi lista të kandidatëve më 11 maj, dhe në fund ishte garuesi i vetëm i regjistruar zgjedhor. Shumë bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it theksuan se mbajtja e zgjedhjeve me vetëm një garues, e vë në pikëpyetje pluralizmin politik.

Më 17 maj, një përfaqësues i Komisionit Evropian deklaroi se ata “nuk shohin se janë plotësuar as kushtet minimale për të mundësuar zgjedhje të besueshme më 5 qershor 2016, të cilat do të njiheshin nga bashkësia ndërkombëtare” dhe se “çdo qeveri që do të rezultonte nga zgjedhjet në të cilat nuk do të merrnin pjesë tre partitë më të mëdha, nuk do të ishte partner i besueshëm për bashkësinë ndërkombëtare”.¹²

Më 18 maj, Gjykata Kushtetuese e shqyrtoi kërkesën e BDI-së, të dorëzuar më 15 maj, ku kërkohej që shpërbërja e parlamentit të shpallej jokushtetuese. Në kërkesë theksohej se zgjedhjet mund të mbahen vetëm brenda 60 ditëve nga dita e shpërbërjes së parlamentit.

Me vendim unanim, gjykata solli ndalesë të përkohshme për vendimin për shpërbërjen e parlamentit, duke e përfshirë edhe shpalljen e zgjedhjeve për 5 qershor nga ana e kryetarit të parlamentit. Periudha e fushatës dhe të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me zgjedhjet u pezulluan derisa gjykata të vendosë për kërkesën e lartpërmendur ose ta heqë ndalesën e përkohshme.

Para vendimit përfundimtar të gjykatës, parlamenti u mblodh më 18 maj dhe votoi unanimisht që ta heqë nga Kodi zgjedhor datën e 5 qershorit si datë të caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.¹³ Nuk u caktua datë e re për mbajtjen e zgjedhjeve. Më 25 maj, Gjykata Kushtetuese e miratoi kërkesën e BDI-së dhe e shpalli shpërbërjen e parlamentit si jokushtetuese, dhe me këtë e anuloi vendimin e kryetarit të parlamentit për t'i shpallur zgjedhjet e 5 qershorit. Paraprakisht, gjykata dy herë e refuzoi rastin e ngjashëm për shkak se u deklarua si jokompetente për të vendosur për këtë çështje. Disa bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it thanë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese ishte i ndikuar nga zhvillimet politike.

Në mbledhjen e mbajtur më 18 maj, parlamenti i miratoi dorëheqjet e ministrave të LSDM-së që ishin dorëzuar më 6 prill, dhe i zëvendësoi ata me përfaqësues të koalicionit në pushtet të VMRO-DPMNE-së. LSDM-ja dhe PDSH-ja thanë se është shkelur Marrëveshja e Përzhinës, pasi që njëra nga dispozitat e saj ishte edhe krijimi i qeverisë së përkohshme.

¹² Shihni [raportin e medias](#) për deklaratën.

¹³ Të gjithë deputetët e pranishëm (96) votuan për këtë vendim. PDSH-ja nuk mori pjesë në votim.

Parlamenti poashtu e ndryshoi edhe Ligjin për amnisti që t'i mundësojë kryetarit të shtetit që t'i tërheqë amnistinë e dhëna më parë, gjë që kryetari e bëri më 6 qershor.¹⁴ Një numër i përfaqësuesve të opozitës inicuan procedurë për heqjen e kryetarit Ivanov nga detyra për shkak të shkeljes së Kushtetutës gjatë dhënies së amnistive. Më 21 qershor, parlamenti nuk e arriti shumicën e dy të tretave që nevojitej për të kaluar kjo iniciativë.

IV. KORNIZA LIGJORE

Zgjedhjet janë të rregulluara me Kushtetutë dhe me Kodin zgjedhor, të plotësuar me rregullat që i shpall KSHZ-ja.¹⁵ Kodi zgjedhor është miratuar në vitin 2006, mirëpo që atëherë është ndryshuar dukshëm.

Pas Marrëveshjes së Përzhinës, u krijua një grup pune me pjesëmarrje të VMRO-DPMNE-së, LSDM-së, BDI-së dhe PDSH-së. Grupi arriti konsensus për reformën zgjedhore dhe më 9 nëntor parlamenti miratoi një numër të rëndësishëm të amandamenteve.¹⁶ Me këto ndryshime u bë përpjekje që të trajtohen shumica e rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it, veçanërisht ato që kishin të bëjnë me parimin e të drejtës së barabartë të votës për votimin jashtë vendit, përbërjen dhe kompetencat e KSHZ-së, terrenin e barabartë në aspekt të mbulimit mediatik gjatë periudhës zgjedhore, përforsimin e raportimit dhe revizionit për financimin e partive dhe të fushatës, masat e përmirësuara mbrojtëse për ndarjen e partisë nga shteti, vendosjen e afateve kohore për gjykatat që të vendosin për kontestet zgjedhore dhe qartësimin e definicionit për zhvillimin e fushatës dhe periudhën e fushatës. U futën fotografitë e votuesve në listat zgjedhore dhe shënimi me ngjyrë i gishtit të madh të votuesit si masa të mundshme mbrojtëse kundër votimit të shumëfishtë.

Edhe pse këto ndryshime paraqesin përpjekje për përmirësimin e Kodit zgjedhor, një numër i bashkëbiseduesve të MVZ të OSBE/ODIHR-it mendojnë se ndryshimet e fundit kanë ndikuar negativisht në atë se si palët e përfshira në procesin zgjedhor i kuptojnë dispozitat dhe në aftësinë e tyre për t'i kryer funksionet e tyre.¹⁷ Për shembull, shumë pak palë të përfshira në procesin zgjedhor kishin njohuri ose i kishin kuptuar dispozitat e reja për reklamimin politik duke i përdorur posterët, afishet dhe tabelat reklamuese.

Poashtu, dispozitat për fushatën e parakohshme nuk ishin efektive për shkak se definicioni i garuesve në zgjedhje që nuk mund të zhvillojnë fushatë është i kufizuar në ata që janë të konfirmuar si kandidatë nga KSHZ-ja, gjë që nuk ndodh deri atëherë kur duhet të fillojë fushata. Poashtu, duhet të qartësohen edhe dispozitat për procedurat për regjistrimin e votuesve jashtë vendit që t'u mundësohet e drejta e votimit të gjithë votuesve që kanë të drejtë vote. Bashkëbiseduesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kishin mendim të ngjashëm se Kodi zgjedhor ka nevojë për rishikim të plotë. Ata poashtu theksuan se po aq i rëndësishëm është edhe implementimi i plotë dhe efektiv i Kodit zgjedhor.

¹⁴ Më 27 maj, kryetari i shtetit e tërhoqi pjesërisht vendimin e tij dhe me këtë u përfshinë 22 veta: kryetarët e VMRO-DPMNE-së dhe të LDSM-së, figura të tjera politike dhe një anëtar i KSHZ-së.

¹⁵ Korniza ligjore poashtu e përfshin edhe Ligjin për partitë politike, Ligjin për financimin e partive politike, Kodin Penal, Ligjin për media dhe Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

¹⁶ Propozimi i miratua me 104 vota nga gjithsej 123 (108 deputetë ishin të pranishëm).

¹⁷ Seksioni II.2.b i [Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore](#) i vitit 2002 i Komisionit për demokraci nëpërmjet ligjit (Komisioni i Venedikut) të Këshillit të Evropës (KE) rekomandon që "elementet themelore të ligjit zgjedhor ...nuk duhet të ndryshohen më pak se një vit përpara zgjedhjeve". Megjithatë, plotësimi i rekomandimeve konsiderohet përjashtim i parimit të stabilitetit të ligjit zgjedhor. Shih Seksionin II.2 të deklaratës interpretuese për stabilitetin e ligjit zgjedhor.

Kodi zgjedhor ka nevojë për rishikim të plotë që të harmonizohet brendia e tij, e poashtu të harmonizohet edhe me ligjet e tjera relevante. Rishikimi duhet të bëhet pas konsultimeve të bëra me të gjitha palët e interesuara politike dhe organizatat relevante të shoqërisë civile. Kjo duhet të përfundohet shumë më herët, para se të mbahen zgjedhjet e ardhshme. Duhet të realizohen trajnime për stafin zgjedhor dhe programe për ngritjen e vetëdijes publike për ta përmirësuar implementimin efektiv të Kodit zgjedhor.

V. SISTEMI ZGJEDHOR

Ndërmjet 120 dhe 123 deputetë janë zgjedhur sipas sistemit proporcional të përfaqësimit nga listat e mbyllura. Prej tyre, 20 deputetë janë zgjedhur në secilën nga 6 njësitë zgjedhore të vendit. Si rezultat i ndryshimeve të vitit 2015 në Kodin zgjedhor, deri në tre deputetë mund të zgjidhen nga njësia e vetme zgjedhore jashtë vendit.¹⁸

Sistemi i ri i votimit jashtë vendit ishte përpjekje për t'i balancuar votat e votuesve në vend dhe atyre jashtë vendit.¹⁹ Më 13 maj, KSHZ-ja e anuloi votimin jashtë vendit pasi që konsideroi se janë regjistruar numër i pamjaftueshëm i qytetarëve për të votuar.²⁰ Me këtë vendim, në mënyrë efektive iu mor e drejta e votimit të gjithë votuesve të regjistruar jashtë vendit, pasi që KSHZ-ja nuk ofroi dispozitë alternative që ata të mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës.

Në qoftë se nuk ndryshon sistemi aktual i votimit jashtë vendit, duhet të përgatiten dispozita alternative që do t'u mundësojnë votuesve ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në qoftë se anulohet votimi jashtë vendit.

Më 13 maj, KSHZ-ja i dërgoi letër ministrit për drejtësi dhe kryetarit të parlamentit, ku i njofton se tre nga gjashtë njësitë zgjedhore kanë dallim më të madh në numrin e votuesve se sa 5 përqindëshi i lejuar me Kodin zgjedhor.²¹ Në dhjetor të vitit 2015, KSHZ-ja i ka njoftuar paraprakisht këto institucione për këtë jokonsekuencë, mirëpo nuk u ndërmorr asnjë veprim për t'i ndryshuar njësitë zgjedhore para shpërbërjes së parlamentit në prill.

Në Kodin zgjedhor nuk është paraparë procedurë për caktimin e kufinjve të njësive zgjedhore e as kritere në bazë të cilave përcaktohen ato, që është në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare. Me Kodin zgjedhor çdo njësi zgjedhore i janë ndarë një numër i caktuar i vendvotimeve.²² Madje, ligji e obligon KSHZ-në t'i ndajë vendvotimet me më shumë se 1.000

¹⁸ Sipas sistemit të mëparshëm, një deputet zgjidhej nga çdo njësi zgjedhore jashtë vendit.

¹⁹ Që të zgjidhet, kandidati i parë duhet të fitojë numër të njëjtë të votave sikurse dhe deputeti i zgjedhur me numrin më të vogël të votave në njësitë zgjedhore të vendit; që të zgjidhet kandidati i dytë duhet të fitojë dyfish më tepër vota se sa deputeti i parë dhe për t'u zgjedhur kandidati i tretë duhet të fitojë tre herë më shumë vota se sa kandidati i parë. Në qoftë se nuk arrihet pragu i përcaktuar, nuk zgjidhet asnjë kandidat.

²⁰ U pranuan 4,871 kërkesa për votim jashtë vendit, ndërsa numri minimal i votave për të fituar një mandat ishte 6,478.

²¹ Dallimet ishin -5.9 për qind në njësinë zgjedhore numër 3, -5.1 për qind në njësinë zgjedhore numër 4 dhe +6.5 për qind në njësinë zgjedhore numër 6. Seksioni 1.2.2.iv i Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore i vitit 2002 i Komisionit të Venedikut rekomandon që “devijimi i lejueshëm nga norma nuk duhet të jetë më shumë se 10%, dhe kurrsesi nuk duhet të jetë më i lartë se 15%, me përjashtim të rrethanave të veçanta”.

²² Njësitë aktuale zgjedhore u caktuan me ndryshimet e vitit 2014 të Kodit zgjedhor. Paragrafi 17 i Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore të Komisionit të Venedikut thekson se mandatet duhet të rishpërndahen në bazë të një orari të përcaktuar edhe sipas mundësisë jashtë periudhave zgjedhore sepse në këtë mënyrë zvogëlohen rreziqet për manipulim politik. Kjo duhet të bëhet nga një komision ku shumica e anëtarëve do të ishin të pavarur, do të kishte përfaqësim të balancuar të partive dhe aty ku është e nevojshme, do të kishte përfaqësues të pakicave kombëtare, dhe i cili do të votohej nga parlamenti. Paragrafi II.2.b parasheh se “Elementët themelore të ligjit zgjedhor, në veçanti, ... hartimi i kufijve të njësive zgjedhore, nuk duhet të

votues të regjistruar para mbajtjes së zgjedhjeve, kështu që lista e vendvotimeve të përfshira në Kodin zgjedhor nuk është gjithmonë e saktë.

Për t'u siguruar barazia e votës, legjislacioni mund të parashohë rishikim periodik të kufinjve të njësive zgjedhore nga një organ i pavarur. Kur bëhet ridefinimi i kufinjve të njësive zgjedhore kjo duhet të bëhet me kohë, në mënyrë transparente, të paanshme dhe inkluzive.

VI. ADMINISTRATIMI I ZGJEDHJEVE

Administrata zgjedhore në tre nivele përbëhet nga KSHZ-ja, 80 Komisione komunale zgjedhore (KKZ), 3.480 Këshilla zgjedhore (KZ). KSHZ-ja mbështetet nga 34 zyra rajonale dhe lokale të saj.

KSHZ-ja është përgjegjëse për mbarëvajtjen e përgjithshme të zgjedhjeve. KKZ-të janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në çdo komunë, për emërimin dhe trajnimin e KZ-ve, paraqitjen në tabela dhe shpalljen e rezultateve komunale, si dhe përgatitjet e tjera teknike sipas udhëzimeve të KSHZ-së. KZ-të janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procedurave në ditën e zgjedhjeve nëpër vendvotime.

Pas Marrëveshjes së Përzhinës, përbërja e KSHZ-së u zgjerua prej shtatë në nëntë anëtarë. Përveç gjashtë përfaqësuesve të partive parlamentare të emëruar nga partitë në pushtet (VMRO-DPMNE-ja – 2 dhe BDI-ja – 1) dhe opozitës (LSDM-ja – 2 dhe PDSH-ja – 1), në komision u përfshin edhe tre ekspertë të pavarur që nuk i takonin asnjë partie politike.²³ KSHZ-ja e re u emërua me mandat pesëvjeçar nga parlamenti më 16 dhjetor 2015, pesë muaj më vonë se sa që ishte paraparë në Marrëveshjen e Përzhinës. Kryetari i KSHZ-së dhe zëvendësi i tij u zgjodhën nga radhët e anëtarëve jopartiakë. Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it, resurset e KSHZ-së u përforcuan duke punësuar punëtorë të rinj në departamentin juridik dhe në sektorin për TI, si dhe në disa zyra rajonale. Mirëpo, të gjitha këto janë vende të përkohshme të punës deri më 31 dhjetor 2016.

Për t'u siguruar qëndrueshmëria administrative e KSHZ-së, të gjitha pozitat e nevojshme mbështetëse të punës duhet të jenë të përhershme, në bazë të procedurave të hapura dhe konkurrenente për punësim.

Fokusi kryesor i KSHZ-së ishte rishikimi i regjistrimit të votuesve. Pas shpalljes së zgjedhjeve, KSHZ-ja i filloi përgatitjet administrative duke e miratuar kalendarin zgjedhor me afate kohore ligjore, si dhe buxhetin operativ.²⁴ KSHZ-ja i respektoi afatet administrative ligjore dhe mbajti mbledhje të rregullta publike. Mirëpo, transparenca e punës së saj u dobësua kur mbante mbledhje në sesione të mbyllura, ku nuk u lejohej qasje vëzhguesve dhe mediave. Megjithatë, në këto mbledhje nuk është marrë asnjë vendim. Përveç kësaj, KSHZ-ja, mbajti dy sesione formale të mbyllura, ku u morën vendime për ndryshime në emërimin e KKZ-ve dhe për disa çështje teknike. Poashtu, pothuajse të gjitha vendimet e KSHZ-së që janë miratuar që nga muaji mars i vitit 2016 nuk janë publikuar në ueb-faqen e tyre, që është në kundërshtim me Rregulloren e punës së KSHZ-

ndryshohen më pak se një vit përpara zgjedhjeve, ose duhet të shkruhen në kushtetutë ose në një dokument ligjor të një niveli më të lartë se sa ligji i zakonshëm.”

²³ Anëtarët e pavarur u emëruan nga parlamenti gjatë procesit të hapur të aplikimit për mandat pesëvjeçar; ata nuk është dashur të jenë anëtarë të partive politike dy vjet para emërimit të tyre.

²⁴ Buxheti ishte 450 milionë denarë të Maqedonisë (7.3 milionë euro); 1 euro = 61.3 denarë të Maqedonisë.

së. Kjo mungesë e transparencës është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mirë.²⁵

Ashtu siç është paraparë me ligj, e me qëllim të rritjes së transparencës dhe besimit publik në punën e saj, të gjitha mbledhjet e KSHZ-së duhet të jenë të hapura për publikun; të gjitha vendimet e KSHZ-së duhet të publikohen në ueb-faqen e tyre pa vonesë.

KSHZ-ja punoi në një ambient të tensionuar politik dhe u kritikua nga opozita dhe disa organizata të shoqërisë civile, të cilat ishin kundër mbajtjes së zgjedhjeve më 5 qershor. Më 15 prill, kur u shpall dita e zgjedhjeve, komisioni votoi me gjashtë vota në favor të asaj se ata janë “të gatshëm që në mënyrë ligjore, të ndërgjegjshme dhe transparente t’i kryejnë të gjitha aktivitetet zgjedhore”. Kryetari i KSHZ-së dhe dy përfaqësuesit e LSDM-së e lëshuan mbledhjen pa votuar dhe përfaqësuesit e LSDM-së nuk u kthyen në mbledhjet e saj deri më 13 maj.

Përderisa zyrtarë rajonale të KSHZ-së rezultuan të ishin të ekipuara me punëtorë me përvojë, zyrtarët lokalë të zgjedhjeve dukej se nuk kishin asnjë fuqi vendimmarrëse dhe shumë prej tyre u ankuan për mungesën e resurseve të nevojshme, si dhe mbështetjen dhe udhëzimet e pamjaftueshme nga ana e zyrës qendrore. Pritja e përhapur në masë të gjerë për anulimin ose shtyrjen e zgjedhjeve të 5 qershorit ndikoi në nivelin e angazhimit të zyrtarëve të zgjedhjeve.

Çdo KKZ përbëhet nga kryetari, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre, që zgjidhen sipas rastit nga radhët e të punësuarve në administratën publike me arsim universitar, me mandat pesëvjeçar. KKZ-të përbëhen nga kryetari dhe dy anëtarë (dhe zëvendësit e tyre) që zgjidhen sipas rastit nga radhët e të punësuarve në administratën publike dhe dy anëtarët e tjerë emërohen nga partitë politike, një nga partitë politike në pushtet dhe një nga opozita.

Pasi mandati pesëvjeçar i KKZ-ve skadoi më 28 prill, KSHZ-ja emëroi anëtarë të rinj të KKZ-ve me anë të programit kompjuterik për zgjedhje të rastit. Si rezultat i zgjedhjes së tillë, nëpunësit shtetërorë u emëruan si anëtarë të KKZ-ve pa konsultime paraprake dhe në disa raste kundër vullnetit të tyre. Më shumë se 50 veta nga 800 anëtarët e KKZ-ve kërkuan nga KSHZ-ja që ta anulojë zgjedhjen e tyre duke theksuar arsye shëndetësore, përkatësinë në ndonjë parti politike, ose mungesën e arsimit të nevojshëm.

Emërimi i KKZ-ve nuk ishte i harmonizuar me kalendarin e afateve kohore për zgjedhjet e vitit 2016, për shkak se kjo u bë gjatë periudhës zgjedhore. Nuk mbeti kohë për t’i trajnuar anëtarët e rinj para se ata të fillojnë me detyrën e tyre, që është në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.²⁶ Poashtu, për shkak të komunikimit të dobët ndërmjet KSHZ-së dhe KKZ-ve, shumë nga anëtarët e rinj nuk ishin të njoftuar për emërimet e tyre në KKZ disa ditë me radhë.²⁷ Krijimi i shumë KKZ-ve u shty edhe më tepër për shkak të ndarjes së resurseve të pamjaftueshme, duke e përfshirë hapësirën për zyra dhe kompjuterët. Si rezultat i vonësve të këtilla, asnjëra nga

²⁵ Paragrafi 19 i Komentit të përgjithshëm të UNHRC-së të vitit 2011, nr. 34 për Nenin 19 të [Konventës ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike \(KNDCP\)](#) thotë “Për ta bërë efektive të drejtën për qasje në informata, Shtetet palë duhet t’i fusin në mënyrë proaktive në domenin publik informatat qeveritare me interes publik. Shtetet palë duhet t’i bëjnë të gjitha përpjekjet për të siguruar qasje të lehtë, të menjëhershme, efektive dhe praktike në informatat e tilla.” Paragrafi 68 i Udhëzimeve dhe raportit shpjegues të Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore të Komisionit të Venedikut thotë se “vetëm transparenca, paanshmëria dhe pavarësia nga manipulimi i motivuar politikisht do të sigurojë administrim adekuat të procesit zgjedhor, duke filluar nga fillimi i periudhës parazgjedhore e deri në fund të përpunimit të rezultateve”.

²⁶ Paragrafi II.3.1.g i Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore të Komisionit të Venedikut thekson se “anëtarët e komisioneve zgjedhore duhet të ndjekin trajnim standard”.

²⁷ Shumë të punësuar rajonalë të KSHZ-së dhe anëtarët e rinj të zgjedhur të KKZ-ve që u kontaktuan nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mësuara për emërimet e tyre nga ueb-faqja e KSHZ-së ose nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it.

KB-të nuk u emërua qoftë deri në afatin e paraparë ligjor më 6 maj, ose deri në anulimin e aktiviteteve zgjedhore më 18 maj. VMRO-DPMNE-ja ishte partia e vetme që ia dorëzoi KB-ve listat e përfaqësuesve të saj.

Duhet të konsiderohet vendosja dhe sigurimi i komunikimit dhe mbështetjes më efektive nga KSHZ-ja për organet lokale për menaxhim të zgjedhjeve. Duhet të realizohen trajnime gjithëpërfshirëse dhe të standardizuara për zyrtarët lokalë të KSHZ-së dhe anëtarët e KKZ-ve para se të shpallen zgjedhjet e reja. Zyrrave lokale duhet t'u ofrohen resurset e nevojshme për realizimin e punës së tyre në kohë dhe në mënyrë efektive.

Kodi zgjedhor parasheh përfaqësim të drejtë të grupeve etnike dhe të çdo gjinie në organet për administrim të zgjedhjeve.²⁸ Nga nëntë anëtarët e KSHZ-së, dy janë gra dhe tre janë shqiptarë etnikë. Është pozitive që rreth 47 për qind e anëtarëve të KKZ-ve janë gra. Në 22 KKZ u siguria numri i paraparë i anëtarëve shqiptarë etnikë. Turqit etnikë ishin të përfaqësuar në tre KKZ, ndërsa serbët etnikë dhe romët ishin të përfaqësuar në nga një KKZ.

VII. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Regjistrimi i votuesve është pasiv, me përjashtim të votuesve me qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, të cilët duhet të regjistrohen në mënyrë aktive. E drejta e votës është e garantuar për të gjithë qytetarët që kanë mbi 18 vjet, me vendbanim të regjistruar në vend dhe që kanë letërnjoftim të vlefshëm ose pasaportë biometrike.

Saktësia e regjistrimit të votuesve, e për pasojë edhe e listave zgjedhore, ishte njëra ndër çështjet më kontestuese në krizën politike. OSBE/ODIHR-i paraprakisht ka rekomanduar procedura të qarta, të koordinuara dhe transparente për të gjitha institucionet që janë të përfshira në azhurnimin e listave të votuesve. Me ndryshimet e vitit 2015 në Kodin zgjedhor, KSHZ-ja u bë organi i vetëm përgjegjës për mirëmbajtjen e regjistrimit të votuesve në bazë të të dhënave që i merr kryesisht nga Ministria për Punë të Brendshme (MPB), ndërsa MPB-ja e mbajti kontrollin mbi bazat e të dhënave të numrave të vetëm amë, paraqitjen e vendbanimit dhe regjistrat e dokumenteve për identifikim personal që u lëshohen qytetarëve.²⁹

A. AZHURNIMI I REGJISTRIT TË VOTUESVE

Në shkurt të vitit 2016, në bazë të metodologjisë së miratuar të saj, KSHZ-ja filloi azhurnimin e regjistrimit të votuesve duke bërë kontrollim të kryqëzuar të bazave të të dhënave të 11 institucioneve shtetërore, si dhe duke bërë kontrole në terren.³⁰ Të gjithë bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it deklaruan se ky proces u tregua si i ndërlikuar në aspekt operativ dhe sfidues në aspekt metodologjik, si dhe kërkonte burime të mëdha financiare dhe njerëzore.

²⁸ Kodi zgjedhor parasheh të drejta të veçanta për pakicat. Në komunat ku bashkësitë etnike përbëjnë së paku 20 për qind të popullatës, ata duhet të përfaqësohen në KKZ-të dhe KZ-të, dhe të gjitha mostrat dhe materialet zgjedhore, duke i përfshirë edhe fletëvotimet, duhet të jenë edhe në gjuhën e tyre. Në zonat ku së paku 20 për qind e qytetarëve e flasin njëri nga gjashtë gjuhët e pranuar zyrtarisht të pakicave, listat e kandidatëve mund të dorëzohen edhe në këtë gjuhë.

²⁹ Numri 13-shifror për identifikim personal përfshin datëlindjen, kodin e rajonit të lindjes dhe gjininë, dhe tre numra unikë.

³⁰ Bazat e të dhënave u takojnë: MPB-së, Regjistrat qendror, Drejtorisë për librat amë, Fondit për sigurim shëndetësor, Agjencisë për punësim, Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, Kadastrës së pronës së patundshme, Ministrisë për Bujqësi, Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, Bankës Popullore dhe Drejtorisë për të hyra publike.

Në fillim të procesit, KSHZ-ja i kërkoi mospërputhjet në bazat e të dhënave dhe i analizoi të dhënat që mund të ishin indikatorë për parregullsi të mundshme, si për shembull persona të vdekur në lista, numër i madh i votuesve të regjistruar në adresë të njëjtë ose votues me emra dhe datëlindje të ngjashme. Nga përafërsisht 1.8 milionë votues, u identifikuan mbi 300,000 votues për të cilët kishte nevojë të qartësohet statusi i tyre. Diku rreth 220,000 të dhëna të votuesve u përcollën disa institucioneve shtetërore për verifikim.

Si rezultat i kryqëzimit të të dhënave, KSHZ-ja publikoi një listë me 89,000 qytetarë të dhënat e regjistrimit të të cilëve duheshite të vërtetohen gjatë vizitave në terren në vendbanimet e votuesve. Ndërmjet 28 marsit dhe 5 prillit, mbi 550 përfaqësues të KSHZ-së i vizituan shtëpitë e rreth 87,000 votuesve dhe plotësuan pyetësorë.³¹ Kontrollat në terren i vërtetuan 47,560 të dhëna (votuesit në fjalë u takuan personalisht), ndërsa 39,792 shënime u përcollën MPB-së dhe Ministrisë për Drejtësi për kontrolle plotësuese administrative. Në fund, u konstatua se pothuajse të gjitha këto dhëna ishin të sakta.

Edhe pse KSHZ-ja bëri përpjekje të konsiderueshme për t'i realizuar kontrollet në terren, të cilat poashtu kishin për qëllim ta risin besimin e publikut, parregullsitë e pretenduara, si për shembull votuesit fiktivë dhe praktikant mashtrore, akoma përdorshin si një nga argumentet kryesore për shtyrjen e zgjedhjeve. Mbështetësit e kësaj ideje e kritikuan procesin se është kaotik, i pasigurt në aspekt metodologjik dhe se në disa raste i ka trajtuar në mënyrë joadekuate pretendimet e mëparshme për mashtrim.

Ndërmjet marsit dhe majit të vitit 2016, KSHZ-ja i dorëzoi MPB-së 45 kërkesa për verifikim të të dhënave. Shumë nga përgjigjet e MPB-së ishin të nënshkruara vetëm nga zëvendës-ministri, pasiqë ministri, përfaqësues i LSDM-së, refuzoi ta bëjë këtë duke thënë se duhet më tepër kohë për të realizuar kontrolle të sakta. Përfaqësuesit e LSDM-së në KSHZ e kontestuan ligjshmërinë e këtyre dokumenteve, mirëpo KSHZ-ja vendosi që t'i pranojë ato.³²

Ministri i brendshëm poashtu kërkoi nga KSHZ-ja që t'i heqë nga lista rreth 130,000 votues që kanë pasaportë të vlefshme mirëpo nuk kanë dokument të vlefshëm identifikimi për ta dëshmuar vendbanimin. KSHZ-ja e refuzoi këtë kërkesë me arsyetimin se ligji parasheh se regjistrimi i votuesve mund të bëhet qoftë me letërnjoftim ose me pasaportë të vlefshme.

Njëra nga kërkesat më të rëndësishme të KSHZ-së për MPB-në kishte të bëjë me 73,000 votues që ishin identifikuar se duhet të konfirmohet vendbanimi i tyre. Edhe pse MPB-ja formalisht e konfirmoi ligjshmërinë e këtyre të dhënave, shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it thanë se është pikëpyetje se a është bërë ky verifikim në mënyrë të përpiktë.

Njëri nga shembujt kryesorë për shqetësimet në lidhje me parregullsitë në regjistrim ishte rasti i ashtuquajtur "Votuesit e Pustecit" – qytetarë që jetojnë në Republikën e Shqipërisë, e drejta e të cilëve për të votuar kontestohet për shkak të statusit të paqartë të vendbanimit.³³ Këta persona, gjoja janë shtuar në listat e votuesve në komunën Qendër të Shkupit për të ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve lokale.³⁴ Sipas MPB-së, në janar të vitit 2016, gjithsej 349 letërnjoftime të këtyre personave u anuluan për shkak se nuk kishin të drejtë ta paraqesin vendbanimin në adresë të caktuar.

³¹ 2.000 votuesit e mbetur nuk kishin asnjë adresë në bazat e të dhënave dhe si të tillë nuk ishin votues me të drejtë vote.

³² Nenet 46 dhe 47 të Ligjit për qeverinë që u futën si rezultat i Marrëveshjes së Përzhinës parashohin që të gjitha dokumentet e MPB-së që kanë të bëjnë me zgjedhjet duhet të nënshkruhen nga ministri dhe zëvendësi i tij.

³³ Pusteci është komunë në Republikën e Shqipërisë ku banojnë shumica e këtyre qytetarëve.

³⁴ KSHZ-ja identifikoi 32 persona me vendbanim në adresa të objekteve qeveritare, fetare ose afariste.

Vazhduan pretendimet për të dhëna fiktive në regjistrin e votuesve, pasi që shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it theksuan se numri i lartë i përgjithshëm i votuesve është i dyshimtë, duke u bazuar në numrin e qytetarëve sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2002. Pasaktësia e listave zgjedhore poashtu u shfrytëzua si argument nga shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it për shtyrjen e zgjedhjeve. Duke u përgjigjur në këto pretendime dhe në bazë të kërkesës së KSHZ-së, MPB-ja njoftoi se deri më 31 mars kishte 2,464,925 qytetarë në regjistrin e shtetasve, duke i përfshirë edhe 1,956,518 të moshës mbi 18 vjet dhe rreth 150,000 pa vendbanim ose dokument të vlefshëm të identifikimit. Poashtu, raporti i fundit për përparimin në azhurnimin e listave zgjedhore që u publikua nga KSHZ-ja më 26 prill, nuk zbuloi dëshmi për regjistrim të rrejshëm të votuesve. Pothuajse të gjitha 300,000 të dhënat, të cilat fillimisht ishin identifikuar si të dyshimta nga KSHZ-ja, u shpallën të vlefshme. U bënë ndryshime shumë të vogla, kryesisht duke i hequr nga lista mbi 1,100 persona të vdekur që u identifikuan gjatë kontrollimeve të kryqëzuara të të dhënave elektronike.

B. SHIKIMI PUBLIK I LISTAVE ZGJEDHORE

Shikimi publik i listave preliminare zgjedhore për zgjedhjet e 5 qershorit u realizua ndërmjet 25 prillit dhe 9 majit në 34 zyra rajonale dhe lokale të KSHZ-së. Votuesit mund t'i kontrollonin të dhënat e tyre në mënyrë elektronike, mirëpo jo edhe të dhënat e qytetarëve të tjerë, siç është paraparë me Kodin zgjedhor. Sistemi i verifikimit publik ishte më i pavoritshëm për ata që nuk kanë qasje në internet dhe për ata që jetojnë në zona rurale.

Procesi i shikimit nuk u implementua në mënyrë të njëjtë në gjithë vendin – përderisa në disa zyra votuesit mund t'i kontrollonin të dhënat e tyre nëpërmjet numrit të tyre amë, në disa zyra të tjera kjo mund të bëhej edhe nëpërmjet emrit, adresës dhe numrit të vendvotimit. Vetëm 4,716 votues e verifikuan saktësinë e të dhënave të tyre. Deri më 17 maj, në listat zgjedhore kishte 1,804,348 votues të regjistruar.

Më 30 mars KSHZ-ja duhet t'i heqë listat zgjedhore nga ueb-faqja për shkak të vendimit të Drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale, që e ndalonte publikimin e të dhënave personale të votuesve duke e përfshirë emrin, gjininë, adresën, datëlindjen dhe numrin e vendvotimit.³⁵ Pamundësia që votuesit t'i kontrollojnë listat zgjedhore gjatë kësaj kohe ndikoi në transparencën dhe besimin publik në cilësinë e listave zgjedhore.³⁶

Për ta rritur besimin publik dhe për t'u ofruar votuesve qasje më të lehtë për t'i verifikuar listat zgjedhore, duhet të konsiderohet mundësia për vendosjen e pjesëve të shtypura nga listat zgjedhore në vende të përshtatshme për votuesit, mundësisht në vendvotime.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua për një numër shembujsh të ekzistimit të pretenduar të votuesve fiktivë (të ashtuquajtur "votues fantomë") dhe për parregullsi të tjera.³⁷ MVZ-ja e ndoqi një mostër të zgjedhur në mënyrë të rastit të këtyre parregullsive; megjithëse shumë nga

³⁵ Drejtoria theksoi se publikimi i listave zgjedhore me këto informata paraqiste shkelje të nenit 5(1) dhe (4) të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Mirëpo, neni 31 (28-d) i Kodit zgjedhor e obligon KSHZ-në t'i publikojë listat zgjedhore në ueb-faqen e saj me emrin, mbiemrin dhe adresën e votuesit. Lista e 89,000 votueseve, poashtu përfshinte informata për gjininë dhe datëlindjen. Lista kombëtare mundësonte që një votues të mund t'i kontrollojë të gjithë banorët e regjistruar në cilëndo adresë. Rreth 6,000 votues bënë denoncime onlajn në lidhje me mospërputhjet në të dhënat e votuesve të regjistruar.

³⁶ Paragrafi 1.2.iii i Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore të Komisionit të Venedikut thekson se "regjistrat zgjedhorë duhet të publikohen patjetër".

³⁷ Shumica dërmuese e shembujve të "votuesve fantomë" që iu prezantuan MVZ-së së OSBE/ODIHR-it kishin të bëjnë me njerëz që jetojnë jashtë vendit, regjistrimi i të cilëve gjoja mund të shfrytëzohet për votim të rrejshëm.

pretendimet që u kontrolluan u dëshmuar si të pavërteta ose kishin të bëjnë me gabime gjatë regjistrimit, të cilat tashmë ishin korrigjuar, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërtetoi raste të votuesve që ishin të regjistruar në adresa që nuk ekzistonin, që mund të jenë ose regjistrim nga pakujdesia ose gabime administrative.³⁸

Më 14 maj, KSHZ-ja ua dha listat zgjedhore katër partive më të mëdha politike, të cilat kishin pesë ditë për të kërkuar ndryshime. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it nuk është e informuar se partitë politike kanë bërë ndonjë kërkesë deri në afatin e fundit, më 22 maj.

Më 26 maj, KSHZ-ja e publikoi listën e plotë zgjedhore në ueb-faqen e saj, duke siguruar qasje të gjerë publike në të dhënat e regjistruara, pasi që listat mund të kontrolloheshin sipas numrit të vetëm amë, emrit dhe adresave. Votuesit kishin mundësi të paraqiten personalisht në zyrat lokale të KSHZ-së për të kërkuar që të bëhet çfarëdo qoftë ndryshimi. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it nuk është e informuar se ndonjë votues apo ndonjë palë tjetër ka kërkuar të bëhet ndonjë ndryshim.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it e vëzhgoi diskutimin e vazhdueshëm për zëvendësimin e sistemit aktual për regjistrimin pasiv të votuesve me një sistem të regjistrimit aktiv, si mënyrë për t'i parandaluar parregullsitë e pretenduara. Mirëpo, disa bashkëbisedues të OSBE/ODIHR-it theksuan se regjistrimi aktiv është i shtrenjtë, merr shumë kohë dhe ka gjasa t'ua marrë të drejtën e votës votuesve që nuk kanë mundësi t'i vizitojnë qendrat e regjistrimit për arsye personale, si për shembull për shkak të hendikepit ose për shkak se jetojnë jashtë vendit.

Sistemi aktual i regjistrimit të votuesve që bazohet në numrin e vetëm amë mund të sigurojë saktësi të listave zgjedhore dhe të ofrojë masa të mjaftueshme mbrojtëse kundër regjistrimit të rrejshëm dhe atij të dyfishtë nëse zbatohet në mënyrë konsekuente dhe të drejtë. Megjithatë MPB-ja është përgjegjëse për saktësinë e të dhënave, po aq me rëndësi është që edhe qytetarët me kohë t'i informojnë autoritetet relevante për ndonjë ndryshim në të dhënat e tyre personale apo të vendbanimit, siç është e paraparë me ligj.³⁹

KSHZ-ja dhe MPB-ja duhet të vazhdojnë me e procesin e azhurnimit të regjistrit të votuesve nëpërmjet angazhimit të koordinuar në bazë të përgjegjësive dhe procedurave të qarta. Duhet të ndahen resurset adekuate dhe koha e nevojshme për ta realizuar këtë detyrë para zgjedhjeve të ardhshme. Ky proces duhet të jetë transparent dhe duhet të sigurojë qasje për partitë politike dhe shoqërinë civile. Kjo duhet të shoqërohet me një fushatë për informim publik me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve në saktësinë e regjistrimit të votuesve.

VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdo votues me të drejtë vote mund të jetë kandidat për deputet, përveç atyre që janë dënuar me dënim të plotfuqishëm gjyqësor me dënim me burg më shumë se gjashtë muaj dhe nuk e kanë vuajtur dënimin e tyre. Ligji, poashtu përcakton një sërë pozitash qeveritare dhe pozitash që kanë lidhje me qeverinë që nuk janë të përshtatshme për kandidim.⁴⁰ Përveç kësaj, deputetët nuk mund të

³⁸ Për shembull, rreth 20 votues në çdo rast ishin regjistruar në adresa joekzistuese në Shkup, në komunën e Kisella Vodës dhe në Veles.

³⁹ Neni 3 i Ligjit për paraqitjen e vendbanimit të përhershëm dhe të përkohshëm të qytetarëve parasheh se “gjatë ndryshimit të vendbanimit të përhershëm qytetarët janë të obliguar ta çrregjistrojnë vendbanimin e përhershëm paraprak dhe ta paraqesin vendbanimin e ri të përhershëm brenda tetë ditëve nga dita e shpërnguljes”.

⁴⁰ Këtu bëjnë pjesë pozita e kryetarit të shtetit, kryeministrit, ministrit, gjykatësit, prokurorit, avokatit të popullit dhe zyrtarëve të tjerë të zgjedhur ose të emëruar nga parlamenti.

punojnë në organet e administratës shtetërore e as nuk mund të angazhohen në ndonjë biznes ose aktivitet tjetër fitimprurës.

Kandidatët mund të emërohen nga partitë politike, koalicionet e partive politike, ose grupe të votuesve. Për listat e dorëzuara nga grupet e votuesve duhet të dorëzohen së paku 1.000 nënshkrime mbështetëse nga votuesit që jetojnë në njësinë përkatëse zgjedhore. Në përputhje me rekomandimin paraprak të OSBE/ODIHR-it, një votues mund të japë mbështetje për më shumë se një garues të mundshëm. Megjithatë, në kundërshtim me rekomandimin paraprak të OSBE/ODIHR-it, nënshkrimet patjetër duhet të mblidhen në prani të përfaqësuesit të zyrës rajonale të KSHZ-së. Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it, kërkesa për ta vizituar zyrën e KSHZ-së mund të ketë efekt zbindës ose frikësues mbi disa votues, veçanërisht në vendbanimet më të vogla.

Siç u rekomanduara më herët, duhet të konsiderohet mundësia për të ofruar metoda alternative për mbledhjen e nënshkrimeve me qëllim që të zvogëlohet potenciali për frikësim.

Deri në afatin e fundit më 11 maj, KSHZ-ja pranoi tre lista të kandidatëve. Nga katër partitë më të mëdha parlamentare, lista dorëzoi vetëm koalicioni i VMRO-DPMNE-së. Këto lista e respektuan dispozitën e re të Kodit zgjedhor, e cila parasheh që së paku 40 për qind e kandidatëve duhet t'i takojnë gjinisë më pak të përfaqësuar.⁴¹

Kandidatë emëruan edhe dy parti joparlamentare, Lëvizja Kombëtare për Maqedoninë (LKM) dhe Partia Social-Demokratike e Maqedonisë (PSDM). Nuk u dorëzua asnjë listë e pavarur. KSHZ-ja i pranoi listat e VMRO-DPMNE-së më 12 maj dhe i ktheu listat e dy partive të tjera për korrigjim të mangësive.⁴² Më 15 maj, PSDM-ja i tërhoqi listat e saj, ndërsa KSHZ-ja i refuzoi listat e LKM-së për shkak të moskorrigjimit të mangësive të identifikuar.

Për ta shmangur çdo konfuzion dhe refuzimin e listave të kandidatëve për arsye teknike, të gjitha dokumentet e veçanta që kërkohen për çdo listë duhet të shënohen në Kodin zgjedhor.

Procesi i regjistrimit të kandidatëve u përmbyll me vetëm një garues të regjistruar, situatë kjo e cila nuk është rregulluar në mënyrë të veçantë në Kodin zgjedhor.

Rishikimi i Kodit zgjedhor mund të konsiderojë përfshirjen e dispozitave për rregullimin e situatës kur në zgjedhjet parlamentare merr pjesë vetëm një garues zgjedhor.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Kodi zgjedhor e rregullon financimin e fushatave zgjedhore. Të gjitha donacionet dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me fushatën duhet të kalojnë nëpër një llogari të veçantë bankare. Personave privatë që i plotësojnë kushtet u lejohej të dhurojnë deri në vlerën ekuivalente të 3.000 eurove në denarë, ndërsa subjektet juridike mund të dhurojnë deri në vlerën ekuivalente 30.000 eurove.⁴³ Donacionet e huaja ose ato anonime, si dhe ato nga organizatat në pronësi shtetërore, fetare dhe humanitare janë të ndaluara. Zbritjet për reklama politike që ofrohen nga shtëpitë mediatike për

⁴¹ Kjo paraqet rritje të kuotës për 10 për qind nga zgjedhjet e vitit 2014. Çdo i treti dhe i dhjeti kandidat duhet të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Gratë akoma janë më pak të përfaqësuar në pozitat udhëheqëse. Për shembull, të gjitha gjashtë partitë parlamentare udhëhiqen nga burra, dhe vetëm 3 nga 21 ministra janë gra.

⁴² Mangësitë në lista përfshinin mosrespektim të kushtit për përfaqësim të gjinive, emërim të disa kandidatëve të cilët nuk gjendeshin në listën e votuesve, mosdorëzim të kopjes së dokumentit të vlefshëm për identifikim, mosdorëzim të dëshmisë se kandidati nuk është i dënuar.

⁴³ [Rroga mesatare neto në muajin mars të vitit mars 2016](#) ishte 22.053 denarë (360 euro).

pjesëmarrësit në fushatë konsiderohen donacion dhe janë të ndaluara. Një garues në zgjedhje nuk mund të shpenzojë më shumë se sa vlera ekuivalente e 1.8 eurove në denarë për çdo votues të regjistruar në njësinë e caktuar zgjedhore.

Garuesit e zgjedhjeve duhet të dorëzojnë dy raporte të përkohshme dhe një raport përfundimtar për financimin e fushatës në KSHZ, në Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) dhe në Entin shtetëror për revizion (ESHR). Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të OSCE/ODIHR-it, tani kërkohet raportim sipas zërave për shpenzimet financiare të fushatës dhe ESHR-së i është dhënë kompetenca për të kërkuar sqarime plotësuese nga garuesit gjatë procesit të revizionit. Pasiqë zgjedhjet u anuluan vetëm dy ditë pasi filloi fushata, nuk u dorëzua asnjë raport për financim të fushatës.

ESHR-ja e ka për obligim që të bëjë revizion të raporteve përfundimtare për financimin e fushatës në afat prej 60 ditësh nga dita e dorëzimit. Nëse konstatohen parregullsi, ESHR-ja inicon procedurë kundërvajtëse ose ia përcjell këto parregullsi prokurorit përkatës publik në afat prej 30 ditësh nga dita e konstatimit të tyre. ESHR-ja ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të dhëna plotësuese nga garuesit në zgjedhje. ESHR-ja i tha MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se nuk i ka resurset e nevojshme për ta bërë mbikëqyrjen e raporteve të financimit të fushatës zgjedhore për shkak se ata janë revizorë e jo hetues. Pastaj, ata nuk e posedojnë personelin e nevojshëm për të bërë monitorim të shpenzimeve të financimit të fushatës për të përcaktuar se a ka parregullsi.

Monitorimi dhe mbikëqyrja e dispozitave që kanë bëjnë me financimin e fushatës duhet të bëhet nga një agjenci e pavarur që e ka personelin dhe ekspertizën e duhur për të bërë monitorim efektiv të parregullsive. Në qoftë se ajo është ESHR-ja, atyre duhet t'u ofrohen kompetencat dhe resurset e nevojshme.

X. MEDIAT

A. MJEDISI MEDIATIK

Mjedisi mediatik është i ndarë në baza etnike dhe karakterizohet me një numër të madh të shtëpive mediatike që veprojnë në treg të kufizuar të reklamave.⁴⁴ Një numër i bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën brengosje për përkeqësimin e lirisë së mediave për shkak të presionit politik dhe ndërhyrjes së pronarëve në punën e gazetarëve. Përfaqësuesi i OSBE-së për lirinë e mediave u bëri thirrje autoriteteve që të “ta zvogëlojnë presionin ndaj mediave dhe t’i respektojnë zërat e lirë dhe kritikë”.⁴⁵

Transmetuesi publik, Radiotelevizioni i Maqedonisë (RTM), emeton tre kanale kombëtare dhe është i financuar nëpërmjet taksës për radiodifuzion që duhet ta paguajnë amvisëritë dhe subjektet juridike. Poashtu, ai ka të drejtë të kërkojë dhe të pranojë mjete shtesë nga buxheti i shtetit.

Shumica e transmetuesve privatë të cilët i takoi MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it theksuan se kanë profit minimal ose nuk kanë fare profit, dhe se varen nga mbështetja e pronarëve të tyre, si dhe nga reklamat e financuara nga qeveria.⁴⁶ Një numër i bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

⁴⁴ Ka diku rreth 130 transmetues, prej të cilave 5 kanale private që transmetojnë në gjithë shtetin në mënyrë terestriale, dhe 9 kanale që mund të shihen në gjithë territorin nëpërmjet rrjeteve kablloviqe dhe satelitore. *Sitel* dhe *Kanal 5* kanë pozita dominante në tregun e reklamave.

⁴⁵ Shiheni [Komunikatën për shtyp](#) të përfaqësuesit të OSBE-së për lirinë, të datës 17 janar 2015.

⁴⁶ [Raporti vjetor i vitit 2014 për tregun e reklamave](#) i përgatitur nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (ASHMAA), që është organi rregullator i mediave, konstatoi se vetëm *Siteli* ishte profitabil.

theksuan se zgjedhja e transmetuesve për reklamim nga ana e qeverisë kuptohet si shpërblim për mbulimin e favorshëm dhe politikën redaktuese.⁴⁷ Kjo është në kundërshtim me rekomandimin e Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), i cili kërkon që institucionet shtetërore t'i trajtojnë me drejtësi dhe neutralitet të gjitha mediat që pranojnë subvencione të drejtpërdrejta ose indirekte.⁴⁸ Poashtu, ligji ndalon që partitë politike dhe bartësit e funksioneve publike, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, të jenë pronarë të transmetuesve.⁴⁹

Ndarja e reklamave shtetërore duhet të bëhet në mënyrë transparente, objektive dhe jodiskriminuese, duke përfshirë edhe ofrimin e informatave të detajuara për përmbajtjen dhe fondet për reklamat e tilla.

B. KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT

Mbulimi i zgjedhjeve nga shtëpitë mediatike është i rregulluar me Kodin zgjedhor dhe Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale të vitit 2013. Korniza ligjore për mbulimin e zgjedhjeve u ndryshua në masë të konsiderueshme në nëntor të vitit 2015. Tani parasheh kushte të detajuara për reklamat e paguara politike dhe u ndalon transmetuesve dhe pronarëve të tyre që të dhurojnë mjete për garuesit; i shkurton afatet kohore për ankesat në lidhje me mediat dhe procedurat kundërvajtëse dhe i rrit dënimet për shkeljet; ndalon mbulimin e zyrtarëve shtetërorë që e favorizon ndonjë parti politike; mundëson që partitë joparlamentare të fitojnë transmetim pa pagesë në kanalën parlamentar dhe e obligon RTM-në që organizojë debate të rregullta zgjedhore. Ndryshimet, poashtu përfshijnë edhe kushte për mbulimin e fushatës nga portalet në internet. Përkundër këtyre ndryshimeve, shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE-ODIHR-it e potencuan nevojën për reforma të vazhdueshme përmbajtësore.⁵⁰ Si pjesë e Marrëveshjes së Përzhinës, u mbajtën konsultime ndërmjet katër partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile për ta reformuar edhe më tutje ambientin mediatik, mirëpo partitë nuk arritën konsensus, ndërsa ndryshimet që u propozuan nga organizatat e shoqërisë qytetare u hodhën poshtë nga parlamenti më 4 prill.

Kodi zgjedhor e ndalon mbulimin e aktiviteteve të rregullta të institucioneve shtetërore që i promovojnë partitë politike dhe koalicionet. Poashtu, i përcakton edhe kushtet e mbulimit mediatik gjatë periudhës zyrtare të fushatës, madje në disa raste edhe në mënyrë tepërt.

Kodi zgjedhor e obligon RTM-në, si dhe transmetuesit e tjerë dhe mediat e tjera në internet që zgjedhjet t'i mbulojnë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, duke u ofruar garuesve qasje të barabartë. Sipas ligjit, balanca vendoset në bazë të numrit të listave me kandidatë, të cilat konfirmohen zyrtarisht vetëm disa ditë para se të fillojë periudha zyrtare e fushatës. Prandaj, mbulimi i balancuar nuk është i detyrueshëm gjatë fushatës parazgjedhore.

Në janar të vitit 2016, RTM-ja i miratoi Parimet etike dhe profesionale të RTM-së për mbulimin mediatik të procesit zgjedhor, duke caktuar udhëzime të përgjithshme për gazetarët e tyre për mbulimin e zgjedhjeve. Poashtu, Kodi zgjedhor parasheh shumë të detajuara dhe të sakta për

⁴⁷ Sipas statistikave të përgatitura nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë në periudhën 2012-2014, tre stacione kombëtare (*Sitel*, *Kanal 5* dhe *Alfa*), për të cilat ka perceptim të gjerë se e mbështesin partinë në pushtet, kanë pranuar 35 herë më shumë para shtetërore për reklamim shtetëror gjatë tre viteve të fundit në krahasim me stacionet kombëtare që nuk e mbështetën partinë në pushtet (*Alsat-M* dhe *Telma*).

⁴⁸ Neni 8.19 i [Rezolutës së APKE-së 1636 \(2008\) Indikatorët për mediat në demokraci](#).

⁴⁹ Sipas Regjistrimit qendror, kanali më i shikuar *Sitel* është në pronësi të kompanisë Monteko, e cila është në pronësi të djalit të liderit të Partisë Socialiste, që është pjesë e koalicionit të VMRO-DPMNE-së.

⁵⁰ Vendi ka shënuar rënie të dukshme prej vendit të 34 në vitin 2009, në vendin e 118-të në vitin 2016 në [Indeksin global të lirisë së shtypit të përgatitur nga Raportuesit pa kufinj](#). Në vitin 2016, [Rangimi i Lirisë së shtypit nga "Freedom House"](#) për herë të parë e rangoi vendin si "Jo i lirë".

mbulimin e fushatës, që rezultoi me mbulim të tepërt të fushatave të partive kryesore politike.⁵¹ Kjo mund ta sfidojë edhe pavarësinë redaktuese të RTM-së.⁵²

Kodi zgjedhor poashtu përcaktoi kushte të detajuara për reklamat e paguara politike, duke lejuar 18 minuta në orë në përgjithësi.⁵³ Pasiqë ligji poashtu lejoi që 12 minuta në orë të emetohen reklama komerciale, një numër i bashkëbiseduesve të OSBE/ODIHR-it i shpreh mendimet se 30 minuta në orë për reklamin janë shumë. Çmimet për reklamim nuk duhet t'i tejkalojnë çmimet mesatare të reklamave komerciale gjatë tre muajve para se të shpallen zgjedhjet; megjithatë, Kodi nuk parasheh asnjë kontrollim se a e kanë plotësuar mediat këtë kërkesë ose jo.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (ASHMAA) është organi kryesor rregullator për mediet elektronike. Është obligim ligjor që të monitorohen transmetuesit dhe ueb-faqet e tyre nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e votimit, të publikohen raporte javore para fushatës, dhe të publikohen raporte ditore gjatë fushatës. Agjencia nuk ka fuqi ligjore që të shqiptojë dënime të drejtpërdrejta, mirëpo mund ta njoftojë gjykatën për shkeljen e identifikuar. ASHMAA-ja i monitoroi vetëm transmetuesit kombëtarë gjatë fushatës parazgjedhore. Nuk i monitoroi mediet në internet me arsyetimin se nuk kishte definicion të qartë të portaleve në internet në ligj, gjë që u pamundësoi atyre të caktojnë një shembull të qartë për monitorim.

ASHMAA-ja publikoi tre raporte të përkohshme dhe një raport përfundimtar që e mbulonte periudhën parazgjedhore. Raportet konstatuan se transmetuesit privat *Alfa*, *Kanal 5*, *Kanal 5+*, *Sitel* dhe *Nova* nuk ofruan mbulim objektiv dhe të paanshëm siç është paraparë me ligj. Raportet poashtu konstatuan se katër mediet e para të lartpërmendura e koordinuan politikën e tyre redaktuese.⁵⁴ Agjencia nuk ndërmoi asnjë veprim në lidhje me mbulimin e anshëm, edhe pse Kodi zgjedhor i sanksionon shkeljet e tilla, me Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale nuk janë paraparë sanksione.

Kodi zgjedhor mund të ndryshohet për t'i qartësuar kërkesat për raportim të balancuar gjatë fushatës parazgjedhore. Mund të konsiderohet dhënia e resurseve më të mëdha për ASHMAA-në për ta realizuar rolin e saj mbikëqyrës dhe kompetenca për sanksionim që janë efektive, proporcionale dhe dekurajuese.

Më 13 maj ASHMAA-ja ia përcolli gjykatës iniciativën për procedurë kundërvajtëse kundër televizioneve *Alfa*, *Kanal 5* dhe *Sitel* për një numër raportimesh që i mbulojnë aktivitetet e institucioneve shtetërore që e promovonin VMRO-DPMNE-në. Përkundër afatit ligjor 48-orësh, gjykata nuk solli vendim deri në momentin kur u përgatit ky raport.⁵⁵ ASHMAA-ja poashtu

⁵¹ Neni 76a (2) i Kodit zgjedhor parasheh se mbulimi i çdo edicioni informativ duhet të ndahet, edhe atë 30 për qind për lajmet nga vendi dhe bota, 30 për qind për aktivitetet e fushatës të shumicës parlamentare, 30 për qind për opozitën parlamentare dhe 10 për qind për partitë joparlamentare. Mosrespektimi i këtyre kërkesave nga ana e RTM-së mund të rezultojë me shkarkim të drejtorit të përgjithshëm.

⁵² [Rekomandimi CM/Rec\(2007\)15](#) i Komitetit të ministrave të vendeve anëtare i Komisionit të Evropës për Masat që kanë të bëjnë me mbulimin mediatik të fushatës zgjedhore kërkon që korniza rregullatore për mbulimin mediatik të zgjedhjeve ta respektojë pavarësinë redaktuese të mediave.

⁵³ Partitë politike në pushtet dhe opozita mund të blejnë më së shumti tetë minuta, ndërsa partitë që nuk janë pjesë e ndonjë grupi parlamentar dhe partitë joparlamentare mund të blejnë më së shumti një minutë.

⁵⁴ Në [Raportin e parë të përkohshëm](#) dhe në [Raportin përfundimtar](#) u theksua se televizionet *Alfa*, *Kanal 5*, *Kanal 5+* dhe *Sitel* "tregojnë mënyrë të njëjtë ose jashtëzakonisht të ngjashme të raportimit, përpunojnë/potencojnë teza dhe qëndrime të njëjta ..., madje përdorin edhe fotografi të njëjta si material ilustrues, që flet për një koordinim të caktuar në politikën e tyre redaktuese", dhe u konsiderua se kjo është "në kundërshtim me parimin e autonomisë, pavarësisë dhe llogaridhënies së redaktorëve, gazetarëve dhe të tjerëve që janë të përfshirë në krijimin e programeve dhe politikës redaktuese".

⁵⁵ Në bazë të propozimeve të dorëzuara në gjykatë, ndërmjet 25 prillit dhe 5 majit, ASHMAA-ja identifikoi 3 shkelje të tilla në *Sitel*, 16 në *Kanal 5* dhe 20 në *Alfa*.

identifikoi shkelje gjatë periudhës së tretë monitoruese, mirëpo nuk inicoi ndonjë sanksion pasi zgjedhjet u anuluan.

Këshilli për etikë në media (KEM) është organ vetë-rregullator që i shqyrton ankesat në lidhje me përmbajtjet mediatike. Më 12 shkurt, anëtarët e Këshillit e nënshkruan Kartën për raportim etik gjatë zgjedhjeve, ku u angazhuan për raportim të balancuar, të vërtetë, të paanshëm dhe objektiv. KEM-ja nuk bëri asnjë monitorim të mediave e as që zhvilloi ndonjë aktivitet tjetër në lidhje me zgjedhjet gjatë periudhës zgjedhore.

C. KONSTATIMET NGA MONITORIMI I MEDIAVE



MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it bëri monitorim mediatik të shtëpive kryesore transmetuese dhe atyre të shtypura, gjatë periudhës së parafushtës dhe gjatë dy ditëve të fushatës zgjedhore.⁵⁶ Edicionet informative të transmetuesit publik RTM-1 ofruan informata të kufizuara për ngjarjet politike dhe iu shmangën raportimit gjithëpërfshirës në mbulimin e lajmeve ditore. Mbulimi i aktorëve relevantë politikë ishte kryesisht faktik dhe neutral dhe në pjesën më të madhe iu kushtua aktiviteteve të qeverisë (30 për qind), VMRO-DPMNE-së (18 për qind) dhe LSDM-së (15 për qind). Të gjitha partitë e tjera politike kishin mbulim shumë të vogël. Në disa raste, gazetarët e RTM-1 i përzien faktet me mendimet e tyre politike gjatë mbulimit të lajmeve.

Shërbimi në gjuhën shqipe i RTM-2 i kushtoi më tepër vëmendje, në mënyrë proporcionale, partive të shqiptarëve etnikë, veçanërisht BDI-së, të cilës iu kushtua 13 për qind e mbulimit kryesisht neutral, ndërsa LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së iu kushtua nga 12 për qind e mbulimit të llojit të njëjtë.

Emisionet e shumta debatuese shërbyen si platformë për partitë politike për t'i prezantuar pikëpamjet e tyre, megjithatë, kishte mungesë të debatit të mirëfilltë për politikën ndërmjet dy forcave kryesore politike – VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së. Kodi zgjedhor parasheh që transmetuesi publik të organizojë debate ndërmjet partive në pushtet dhe atyre opozitare gjatë periudhës së fushatës. RTM-1 tentoi të organizojë dy debate ndërmjet VMRO-DPMNE-së, LSDM-së, BDI-së dhe PDSH-së; mirëpo vetëm VMRO-DPMNE-je vendosi të marrë pjesë edhe atë vetëm një herë. Megjithëse, *Telma*, *Vesti 24* dhe *Alsat-M* mbajtën debate të rregullta dhe programe me mysafirë, ato i thanë MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se VMRO-DPMNE-ja i ka injoruar ftesat e tyre.⁵⁷

Stacionet më të popullarizuara televizive private, *Sitel* dhe *Kanal 5*, së bashku me televizionin *Alfa*, treguan qasje të unifikuar në mbulimin e lajmeve. Ata i kushtuan ndërmjet 24 dhe 26 për qind të mbulimit të lajmeve me relevancë politike aktiviteteve të VMRO-DPMNE-së, ndërmjet 21 dhe 27 për qind aktiviteteve të LSDM-së dhe rreth 6 për qind të gjitha partive të tjera së bashku. Toni i mbulimit ishte pothuajse ekskluzivisht pozitiv dhe neutral ndaj VMRO-DPMNE-së, zyrtarëve të lartë qeveritarë të saj, si dhe ndaj kundër-protestave të organizuara nga LQMM-ja. Në disa raste, mbulimi i aktiviteteve të qeverisë ishte i lidhur me promovimin e politikave të ardhshme të VMRO-DPMNE-së, që është në kundërshtim me Kodin zgjedhor. Mbulimi i aktiviteteve të LSDM-së dhe i ministrave që e përfaqësojnë këtë parti, Prokurorisë speciale publike dhe demonstratat e organizuara

⁵⁶ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it bëri monitorim mediatik prej 15 prillit deri më 17 maj të këtyre mediave: *RTM-1*, *RTM-2*, *Sitel*, *Kanal 5*, *Telma* dhe *Alsat-M* gjatë periudhës kohore 18:00 – 24:00; *Alfa* gjatë periudhës kohore 17:30 – 00:30; *Vesti 24* gjatë periudhës kohore 20:00 – 22:00. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it poashtu e monitoroi edhe mbulimin e fushatës nga pesë gazeta të përditshme: *Dnevnik*, *Sloboden Pecat*, *Nova Makedonia*, *Koha* dhe *Lajm*. Pasiqë periudha zyrtare e fushatës zgjati vetëm dy ditë, konstatimet nga monitorimi i tyre nuk janë analizuar në këtë raport.

⁵⁷ Përjashtimi i vetëm ishte debati ndërmjet VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së në *Vesti 24* më 3 maj.

nga *Protestoj* ishte kryesisht me ton negativ. Mbulimi përfshinte prezantim selektiv të fakteve dhe të mendimeve të shprehura nga gazetarët, shpeshherë duke përdorur fjali identike të tre transmetuesit.

Për të garantuar mbulim të drejtë dhe qasje për të gjithë garuesit politikë, mediat transmetuese duhet të sigurojnë balancë në lajmet e tyre dhe në raportimin për çështjet aktuale në periudhën e parafushtës, siç është e paraparë me ligj.

Telma dhe televizioni që emetohet vetëm në kabëll *Vesti 24* ofruan mbulim më të balancuar dhe më të detajuar të lajmeve. Të dyja stacionet i kushtuan proporcione të barabarta të mbulimit kryesisht neutral VMRO-DPMNE-së (17 dhe 15 për qind) dhe LSDM-së (15 dhe 12 për qind). *Alsat-M*, që kryesisht emiton program në gjuhën shqipe, poashtu i kushtoi proporcione të barabarta (ndërmjet 10 dhe 12 për qind) mbulimit për VMRO-DPMNE-në, LSDM-në dhe BDI-në, edhe pse ishte kryesisht kritike ndaj VMRO-DPMNE-së dhe neutrale ndaj partive të tjera.

Mbulimi politik në mediet e shtypura ishte më i polarizuar se sa te mediet elektronike. Përderisa *Dnevnik* ishte qartazi kundër LSDM-së, shumica e mbulimit politik nga *Sloboden Pecat* e prezantuan VMRO-DPMNE-në dhe qeverinë në mënyrë negative. Tabloidi *Vest* ofroi mbulim shumë të kufizuar politik, mirëpo me anim kah VMRO-DPMNE-ja. Gazetat në gjuhën shqipe *Koha* dhe *Lajm* më tepër ishin të fokusuar në aktivitetet e partive etnike shqiptare. Përderisa *Koha* kryesisht ishte e fokusuar në aktivitetet dhe projektet e BDI-së, *Lajm* kryesisht e kritikonte BDI-në dhe anëtarët e tyre të qeverisë.

XI. VËZHguesit QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi zgjedhor parasheh vëzhgim ndërkombëtar dhe qytetar të zgjedhjeve. Organizata qytetare për vëzhgim, MOST, u angazhua në monitorimin gjithëpërfshirës të procesit zgjedhor me 80 vëzhgues afatgjatë. Organizata CIVIL kishte 35 vëzhgues afatgjatë. Më 4 maj, MOST-i dorëzoi në KSHZ kërkesën për akreditimin e 27 vëzhguesve; KSHZ-ja nuk i akreditoi ata para se të anulohen zgjedhjet më 18 maj, edhe pse kjo nuk i dëmtoi aktivitetet vëzhguese.

Edhe CIVIL-i edhe MOST-i e kritikuan procesin zgjedhor, veçanërisht në aspekt të kontrollit jotransparent në terren të listave zgjedhore, keqpërdorimit të resurseve shtetërore për qëllime partiake, dhe presionit mbi të punësuarit në administratën publike. MOST-i dhe CIVIL-i theksuan se qeveria nuk arriti të sigurojë kushte për të mbajtur zgjedhje të besueshme.⁵⁸

XII. KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT

Kundërshtimet që kanë të bëjnë me zgjedhjet mund të parashtrihen nga përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve, dorëzuesit e listave të kandidatëve, dhe votuesit. Kundërshtimet shqyrtohen nga KSHZ-ja, ndërsa vendimet e saj mund të ankimohen në Gjykatën administrative, e cila e merr vendimin përfundimtar.⁵⁹ KKZ-të nuk kanë kompetenca për të vendosur për kundërshtimet zgjedhore.

⁵⁸ Shihni deklaratat e [MOST](#)-it dhe të [CIVIL](#)-it.

⁵⁹ Si përjashtim, gjykata kompetente themelore i shqyrton kundërshtimet që kanë të bëjnë me pengimin ose ndërprejen e ngjarjes së fushatës.

Në përgjigje të rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it, me ndryshimet e Kodit zgjedhor të vitit 2015 u shkurtuan afatet për shqyrtimin dhe vendosjen për kundërshtimet zgjedhore dhe parashihet që KSHPK-ja t'i shqyrtojë rastet në sesion publik. Vendimet për kundërshtimet duhet të publikohen në ueb-faqet e tyre.

Përkundër dispozitës kushtetuese që të gjitha shqyrtimet dhe vendimet gjyqësore të jenë publike, Gjykata Administrative veprimi në mënyrë jotransparente, dhe i shqyrtoi dy raste që kishin të bëjnë me zgjedhjet pa mbajtur seancë publike. Gjykatat e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se gjykatësit do të vendosin për këto raste në privatësi. Mosmbajtja e shqyrtimeve të garantuara publike nga ana e Gjykatës Administrative është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare, gjë që e zvogëlon besimin publik ndaj procesit.⁶⁰

Kodi zgjedhor duhet të harmonizohet me Kushtetutën dhe duhet të theksojë në mënyrë të qartë se të gjitha shqyrtimet për rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet duhet të mbahen publikisht dhe vendimet duhet të publikohen menjëherë.

Nga dy rastet, i pari kishte të bëjë me publikimin e listave zgjedhore në ueb-faqen e KSHZ-së. Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale më 29 mars mori vendim me të cilin e urdhëroi KSHZ-në t'i heqë listat zgjedhore nga ueb-faqja e saj, për shkak se kjo është në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Më 9 prill, KSHZ-ja, e apeloj vendimin në Gjykatën Administrative.⁶¹

Edhe pse zgjidhja e rastit nuk duhej të vonohet, gjykata nuk solli vendim deri më 5 maj dhe nuk e publikoi vendimin deri më 16 maj, pasi kaloi afati për shikim publik të listave zgjedhore.⁶² Për shkak të vonësës, votuesit nuk kishin mundësi t'i kontrollojnë listat zgjedhore për parregullsi siç është paraparë në Kodin zgjedhor.

Për të siguruar mjet efektiv, për të gjitha rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet duhet të merret vendim brenda afateve kohore të përcaktuara në mënyrë të qartë në ligj.

Rasti i dytë kishte të bëjë me ankesën ndaj vendimit të KSHZ-së për ta refuzuar listën e kandidatëve të dorëzuar nga LKM-ja për arsye procedurale. Më 17 maj, gjykata konstatoi se për ta kontrolluar se a i plotëson kushtet një kandidat, KSHZ-ja kishte të drejtë legjitime të kërkojë kopje të dokumenteve të identifikimit dhe të dosjes kriminale.

Për dallim nga Gjykata Administrative, Gjykata Kushtetuese mbajti sesione publike gjatë shqyrtimit të ankesës për jokushtetutshmërinë e shpërbërjes së parlamentit dhe e publikoi vendimin e saj ditën kur u bë shqyrtimi.

Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it, KSHZ-ja krijoi një departament juridik për shqyrtimin e kundërshtimeve. Megjithatë, KSHZ-ja nuk e miratoi udhëzimin për të

⁶⁰ Paragrafi 12 i Dokumentit të Kopehnagës të OSBE-së të vitit 1990 thotë se “seancat mund të mbahen para kamerave në kushte të parapara me ligj dhe në përputhje me detyrimet sipas ligjeve ndërkombëtare dhe angazhimeve ndërkombëtare”. Shih poashtu nenin 10 të Deklaratës universale për të drejtat e njeriut dhe nenin 14 të Koneventës ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike.

⁶¹ KSHZ-ja theksoi se neni 31.28.d i Kodit zgjedhor parashih publikimin e listës me emrin, mbiemrin dhe adresën e votuesit në ueb-faqen e KSHZ-së.

⁶² Nuk ka afat ligjor se deri kur duhet gjykata të marrë vendim. Paragrafi II, 3.3 i Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore i Komisionit të Venedikut parashih se “Shtetet duhet të sigurojnë se shkeljet e të drejtave të njeriut dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor do të zgjidhen menjëherë brenda kornizës kohore të procesit zgjedhor dhe në mënyrë efektive nga një organ i pavarur dhe i paanshëm, si për shembull nga ndonjë komision zgjedhor apo nga gjykatat.”

vendosur në lidhje me kundërshtimet dhe ankesat, siç është paraparë me Kodin zgjedhor. Mungesa e udhëzimeve të përhershme në lidhje me kundërshtimet dhe ankesat e pengon mundësinë e palëve të përfshira në zgjedhje që të parashtrajnë kundërshtime, dhe e dëmton efektivitetin e mjeteve ligjore të ndreqjes, siç është paraparë me paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopehnagës të OSBE-së të vitit 1990.⁶³ Poashtu, Kodi zgjedhor parasheh krijimin e sistemit për menaxhim të rasteve dhe të kundërshtimeve, i cili nuk ishte në funksion për këto zgjedhje.

Për të mundësuar mjet efektiv ligjor, KSHZ-ja duhet të përgatisë udhëzime të përhershme në lidhje me procesin e kundërshtimeve dhe të ankesave. Këto rregulla mund të harmonizohen me sistemin e ri për menaxhim të kundërshtimeve.

U vendosën lidhje të drejtpërdrejta telefonike nga disa institucione shtetërore: Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë për të punësuarit në sektorin publik për ta denoncuar çdo rast të presionit që ka të bëjë me zgjedhjet; Zyra e Avokatit të Popullit që qytetarët t'i denoncojnë shkeljet e të drejtave të tyre zgjedhore; Prokuroria publike që qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile ta denoncojnë çdo aktivitet të dyshimtë kriminal që ka të bëjë me zgjedhjet. Sipas këtyre institucioneve, janë pranuar shumë pak thirrje dhe asnjëra nuk ka pasur të bëjë me ndonjë shkelje serioze. Prokurori publik ka pranuar 28 denoncime ose kundërshtime, 14 nga të cilat i janë përcjellë prokurorisë kompetente publike themelore me udhëzime për veprim urgjent dhe raportim kthyes. Nuk është gjetur asnjë bazë për aktivitete të dyshimta kriminale në pretendimet tjera. Prokurori publik e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se do ta mbajë të hapur lidhjen e drejtpërdrejtë telefonike për denoncim të parregullsive zgjedhore dhe do të vazhdojë t'i hetojë rastet që janë denoncuar më herët.

XIII. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Marrëdhëniet ndëretnike mbeten faktor i rëndësishëm në politikën e vendit dhe partitë politike priren që të tërheqin votues nga komunitetet e tyre.⁶⁴ Megjithatë, marrëdhëniet ndëretnike nuk erdhën shumë në shprehje në krizën aktuale politike, dhe marrëdhëniet ndërmjet bashkësive nuk ishin në fokus të ballafaqimit politik.

Bashkësitë më të vogla i shprehën shqetësimin e tyre MVZ-së së OSBE/ODIHR-it për mospërfshirjen në përpjekjet ndërkombëtare dhe vendore për të gjetur dalje nga kriza politike. Ata poashtu thanë se partitë që i përfaqësojnë bashkësitë më të mëdha i shfrytëzojnë resurset administrative dhe punësimet publike për ta siguruar mbështetjen e pakicave. Partitë që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla poashtu u ankuan edhe për mungesën e qasjes në media.

Partitë që e përfaqësojnë bashkësinë etnike shqiptare, e veçanërisht BDI-ja, ishin vendimtare në iniciimin dhe përfundimin e procesit që çoi në anulimin e zgjedhjeve të 5 qershorit. Partitë tjera që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla ishin më të përçara në qëndrimet e tyre. Ato që ishin bashkangjitur koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja ishin të gatshme të marrin pjesë në zgjedhje, ndërsa partitë tjera i thanë MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se nuk kishte kushte për zgjedhje të besueshme dhe se për këtë arsye ato do t'i bojkotonin zgjedhjet.

⁶³ Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopehnagës të OSBE-së të vitit 1990 thotë se "... çdokush duhet të ketë mjete efektive të dëmspërblimit kundër vendimeve administrative, duke garantuar kështu respektimin e të drejtave themelore dhe sigurimin e integritetit ligjor".

⁶⁴ Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë (në vitin 2002) përbërja etnike e vendit është kjo: maqedonas etnikë 64.2 për qind, shqiptarë etnikë 25.2 për qind, turq etnikë 3.9 për qind, romë etnikë 2.6 për qind, serbë etnikë 1.8 për qind, vlllehë etnikë 0.4 për qind dhe të tjerë 2.3 për qind. Një regjistrim tjetër i popullsisë u inicua në vitin 2011, mirëpo u ndërpre.

Pjesëtarët e bashkësive pakicë dhe partitë që i përfaqësojnë ata, veçanërisht shqiptarët etnikë, morën pjesë në protestat anembanë vendit, individualisht, me bashkësitë e tjera dhe si pjesë e lëvizjes *Protestoj*. Në disa fusha, protesta kishte karakter ndëretnik, me simbolet e flamurit të vendit dhe flamujt e shqiptarëve etnikë dhe të komunitetit rom të shfaqura së bashku. Protesta e organizuar nga Këshilli opozitar i shqiptarëve, ku partia *Lëvizja Besa* luan rol kryesor, tërhoqi një numër të madh të përkrahësve, duke paraqitur kërkesa për bashkësinë etnike shqiptare, dhe duke e akuzuar BDI-në për përfaqësimin joadekuat të interesave të bashkësisë.

Pothuajse të gjithë përfaqësuesit e pakicave kombëtare, veçanërisht ata të bashkësive më të vogla, kërkuan nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it futjen e një njësie të vetme zgjedhore në mbarë vendin, si dhe krijimin e masave të tjera të veçanta për promovimin e pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe vendet e rezervuara të deputetëve. Sipas mendimit të tyre, këto masa do t'u mundësonin partive që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla të garojnë veçmas e jo detyrimisht t'u bashkangjiten koalicionëve ekzistues.

Disa bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it i shprehën shqetësimet e tyre se komuniteti rom mund t'i nënshtrohet presionit politik dhe shitjes dhe blerjes së votave. Në të njëjtën kohë, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua për aktivitete të shumta që kishin për qëllim ngritjen e vetëdijes brenda këtij komuniteti, të cilat në disa raste thuhet se kanë rezultuar me zvogëlimin e praktikës së tillë.

XIV. REKOMANDIMET

Këto rekomandime, siç janë paraqitur në gjithë tekstin, ofrohen me synimin për ta përmirësuar zhvillimin e zgjedhjeve në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe për t'i mbështetur përpjekjet për t'i sjellë ato në përputhje të plotë me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhen lexuar së bashku me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it, në veçanti nga raporti përfundimtar i vitit 2014, që mbeten për t'u trajtuar. OSBE/ODIHR-i është i gatshëm që t'u ndihmojë autoriteteve për ta përmirësuar më tej procesin zgjedhor dhe për t'i trajtuar rekomandimet që gjenden në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.⁶⁵

A. REKOMANDIMET PRIORITARE

1. Kodi zgjedhor ka nevojë për rishikim të plotë që të harmonizohet brendia e tij, e poashtu të harmonizohet edhe me ligjet e tjera relevante. Rishikimi duhet të bëhet pas konsultimeve të bëra me të gjitha palët e interesuara politike dhe organizatat relevante të shoqërisë civile. Kjo duhet të përfundohet shumë më herët, para se të mbahen zgjedhjet e ardhshme. Duhet të realizohen trajnime për stafin zgjedhor dhe programe për ngritjen e vetëdijes publike për ta përmirësuar implementimin efektiv të Kodit zgjedhor.
2. Siç është e paraparë me ligj, e me qëllim të rrijës së transparencës dhe besimit publik në punën e saj, të gjitha mbledhjet e KSHZ-së duhet të jenë të hapura për publikun; të gjitha vendimet e KSHZ-së duhet të publikohen në ueb-faqen e tyre pa vonesë.
3. KSHZ-ja dhe MPB-ja duhet të vazhdojnë me procesin e azhurnimit të regjistrimit të votuesve nëpërmjet angazhimit të koordinuar në bazë të përgjegjësisë dhe procedurave të qarta. Duhet të

⁶⁵ Sipas paragrafit 25 të [Dokumentit të Stambollit të OSBE-së të vitit 1999](#), shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan "të ndiqnin menjëherë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet".

ndahen resurset adekuate dhe koha e nevojshme për ta realizuar këtë detyrë para zgjedhjeve të ardhshme. Ky proces duhet të jetë transparent dhe duhet të sigurojë qasje për partitë politike dhe shoqërinë civile. Kjo duhet të shoqërohet me një fushatë për informim publik me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve në saktësinë e regjistrimit të votuesve.

4. Ndarja e reklamave shtetërore duhet të bëhet në mënyrë transparente, objektive dhe jodiskriminuese, duke përfshirë ofrimin e informatave të detajuara për përmbajtjen dhe fondet për reklamat e tilla.
5. Kodi zgjedhor duhet të harmonizohet me Kushtetutën dhe duhet të theksojë në mënyrë të qartë se të gjitha shqyrtimet për rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet duhet të mbahen publikisht dhe vendimet duhet të publikohen menjëherë.

B. REKOMANDIMET E TJERA

Korniza ligjore

6. Rishikimi i Kodit zgjedhor mund të konsiderojë përfshirjen e dispozitave për rregullimin e situatës kur në zgjedhjet parlamentare merr pjesë vetëm një garues zgjedhor.

Sistemi zgjedhor

7. Në qoftë se nuk ndryshon sistemi aktual i votimit jashtë vendit, duhet të përgatiten dispozita alternative që do t'u mundësojnë votuesve ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në qoftë se anulohet votimi jashtë vendit.
8. Për t'u siguruar barazia e votës, legjislacioni mund të parashohë rishikim periodik të kufinjve të njësive zgjedhore nga një organ i pavarur. Kur bëhet ridefinimi i kufinjve të njësive zgjedhore kjo duhet të bëhet me kohë, në mënyrë transparente, të paanshme dhe inkluzive.

Administrimi i zgjedhjeve

9. Për t'u siguruar qëndrueshmëria administrative e KSHZ-së, të gjitha pozitat e nevojshme mbështetëse të punës duhet të jenë të përhershme, në bazë të procedurave të hapura dhe konkurrenente për punësim.
10. Duhet të konsiderohet vendosja dhe sigurimi i komunikimit dhe mbështetjes më efektive nga KSHZ-ja për organet lokale për menaxhim të zgjedhjeve. Duhet të realizohen trajnime gjithëpërfshirëse dhe të standardizuara për zyrtarët lokalë të KSHZ-së dhe anëtarët e KKZ-ve para se të shpallen zgjedhjet e reja. Zyrtarët lokale duhet t'u ofrohen resurset e nevojshme për realizimin e punës së tyre në kohë dhe në mënyrë efektive.

Regjistrimi i votuesve

11. Për ta rritur besimin publik dhe për t'u ofruar votuesve qasje më të lehtë për t'i verifikuar listat zgjedhore, duhet të konsiderohet mundësia për vendosjen e pjesëve të shtypura nga listat zgjedhore në vende të përshtatshme për votuesit, mundësisht në vendvotime.

Regjistrimi i kandidatëve

12. Siç u rekomandua më herët, duhet të konsiderohet mundësia për të ofruar metoda alternative për mbledhjen e nënshkrimeve me qëllim që të zvogëlohet potenciali për frikësim.
13. Për ta shmangur çdo konfuzion dhe refuzimin e listave të kandidatëve për arsye teknike, të gjitha dokumentet e veçanta që kërkohen për çdo listë duhet të shënohen në Kodin zgjedhor.

Fushata

14. Qytetarët, duke i përfshirë edhe të punësuarit në institucionet publike ose shtetërore, nuk duhet t'i nënshtrohen presionit ose frikësimit. Autoritetet duhet t'i inkurajojnë qytetarët në mënyrë aktive që t'i denoncojnë të gjitha rastet e presioneve, duke i mbështetur ato me dëshmi të verifikueshme. Të gjitha rastet dhe pretendimet për presion dhe frikësim duhet të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe të ndiqen penalisht nga autoritetet.

Financimi i Fushatës

15. Monitorimi dhe mbikëqyrja e dispozitave që kanë bëjnë me financimin e fushatës duhet të bëhet nga një agjenci e pavarur që e ka personelin dhe e ekspertizën e duhur për të bërë monitorim efektiv të parregullsive. Në qoftë se ajo është ESHR-ja, atyre duhet t'u ofrohen kompetencat dhe resurset e nevojshme.

Mediat

16. Rekomandohet të zëvendësohet kërkesa ligjore për RTM-në për sasinë e saktë të kohës në çdo edicion informativ kushtuar mbulimit të aktiviteteve të fushatës së partive të veçanta me një kërkesë më të përgjithshme që parasheh paanshmëri dhe balancë duke e respektuar pavarësinë redaktuese të transmetuesit publik.
17. Për të garantuar mbulim të drejtë dhe qasje për të gjithë garuesit politikë, mediat transmetuese duhet të sigurojnë balancë në lajmet e tyre dhe në raportimin për çështjet aktuale në periudhën e parafushatës, siç është e paraparë me ligj.

Kundërshtimet dhe ankesat

18. Për të siguruar mjet efektiv, për të gjitha rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet duhet të merret vendim brenda afateve kohore të përcaktuara në mënyrë të qartë në ligj.
19. Për të mundësuar mjet efektiv ligjor, KSHZ-ja duhet të përgatisë udhëzime të përhershme në lidhje me procesin e kundërshtimeve dhe të ankesave. Këto rregulla mund të harmonizohen me sistemin e ri për menaxhim të kundërshtimeve.

ANEKSI II: LISTA E VËZHguesVE NË MISIONIN PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

Ekipi bazë i MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

Jan	Petersen	Norvegji	Shef i Misionit
Jasmina	Fracassetti	Kroaci	
Laszlo	Belagyi	Hungari	
Alessandro	Rotta	Itali	
Alexandra	Pajevic	Mali i Zi	
Konrad	Olszewski	Poloni	
Pawel	Jurczak	Poloni	
Tomasz	Janczy	Poloni	
Raul	Muresan	Rumani	
Yury	Ozerov	Federata Ruse	
Iegor	Tilpunov	Ukrainë	
Donald	Bisson	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	

Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

Suad	Salkic	Bosnje dhe Hercegovinë
Tereza	Ambrozova	Republika Çeke
Karen Benedikte	Skipper	Danimarkë
Irmeli Maria	Vieno	Finlandë
Sylvain	Ollier	Francë
Andreas	Kunert	Gjermani
Christa	Mueller	Gjermani
Julia Franziska	Ruppel	Gjermani
Cecilia Rose	Keaveney	Irlandë
Alessandro	Gori	Itali
Catharina Maria	Appel	Holandë
Servatius	Wiemers	Holandë
Per N.	Svartefoss	Norvegji
Cristian	Negrila	Rumani
Elof David	Dahmen	Suedi
Vida Koren	Holm	Suedi
Sascha Michel	Alderisi	Zvicër
Monica Angela	Giambonini	Zvicër
Anna	Galan	Ukrainë
Roger	Bryant	Mbretëria e Bashkuar
Joan	Pearce	Mbretëria e Bashkuar
Nicholas	Alexander	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Andral	Bratton	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Sheila	Jaghab	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

PËR OSBE/ODIHR-in

Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që u ndihmon vendeve anëtare "të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale, t'i përmbahen sundimit të ligjit, t'i promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) t'i ndërtojnë, t'i përforcojnë dhe t'i mbrojnë institucionet demokratike, si dhe ta promovojnë tolerancën në gjithë shoqërinë" (Dokumenti i Samitit të Helsinkit të vitit 1992). Ky njihet si dimension i njerëzor i OSBE-së.

OSBE/ODIHR-i, me seli në Varshavë të Polonisë, u krijua si Zyrë për zgjedhje të lira në Samitin e Parisit në vitin 1990 dhe filloi me punë në maj të vitit 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për ta pasqyruar mandatin e zgjeruar, për t'i përfshirë të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot ajo ka mbi 130 të punësuar.

OSBE/ODIHR-i është organizata kryesore në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Për çdo vit, ajo e koordinon dhe e organizon shpërndarjen e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar se a janë zhvilluar zgjedhjet në rajonin që e përfshin OSBE-ja në përputhje me Angazhimet e OSBE-së, standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe legjislacionin nacional. Metodologjia e saj unike ofron një qasje të thellë në tërësinë e procesit zgjedhor. Me anë të projekteve për ndihmë, OSBE/ODIHR-i u ndihmon vendeve anëtare ta përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Aktivitetet e Zyrës në fushën e **demokratizimit** përfshijnë: sundimin e të drejtës, mbështetjen ligjore, qeverisjen demokratike, emigrimin dhe lirinë e lëvizjes, dhe barazinë gjinore. OSBE/ODIHR-i për çdo vit zbaton një numër programesh të dedikuara për mbështetje, me të cilat synohet zhvillimi i strukturave demokratike.

OSBE/ODIHR-i poashtu u ndihmon vendeve anëtare t'i përmbushin obligimet e tyre për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale që është në përputhje me përkushtimet e OSBE-së për dimensionet njerëzore. Kjo realizohet duke punuar me partnerë të ndryshëm për ta kultivuar bashkëpunimin, për t'i ndërtuar kapacitetet dhe për të ofruar ekspertizë në fushat tematike, duke i përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, edukimin dhe trajnimin për të drejtat e njeriut, mbikëqyrjen dhe raportimin për të drejtat e njeriut, të drejtat e njeriut të grave dhe sigurinë e tyre.

Në fushën e **tolerancës** dhe të **mosdiskriminimit**, OSBE/ODIHR-i u ofron përkrahje vendeve anëtare në përforcimin e kapacitetit për t'iu përgjigjur krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të mostolerancës. Aktivitetet e OSBE/ODIHR-it që kanë të bëjnë me tolerancën dhe mosdiskriminimin janë të fokusuara në këto fusha: legjislacioni, trajnimet për zbatimin e ligjeve, mbikëqyrja, raportimi dhe ndjekja e përgjigjeve ndaj krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si dhe aktivitete edukative për promovimin e tolerancës, respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i u ofron këshilla vendeve anëtare për politikat e tyre që kanë të bëjnë me romët dhe sintit. Ajo e promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjetëzimin te komuniteti rom dhe ai sinti, dhe e inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe të sinti në organet e politikë-bërjes.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it realizohen në koordinim dhe në bashkëpunim të ngushtë me vendet anëtare të OSBE-së, institucionet dhe operacionet e OSBE-së në terren, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Më tepër informacione mund të gjeni në ueb-faqen e ODIHR-it (www.osce.org/odihr).